



STUDIME POSDIPLOMIKE – CIKLI I DYTË

TEMA:

**PËRDORIMI EFEKTIV I TIK-ut NË SHKOLLAT FILLORE TË
KOSOVËS**

RAST STUDIMOR :

**SHKOLLA FILLORE E MESME E ULËT “VËLLEZËRIT
FRASHËRI” NË QYTETIN E LIPJANIT**

Mentori:

Prof.Dr.Mentor Hamiti

Kandidati:

Ekrem Salihu

PËRMBAJTJA

LËNDA E HULUMTIMIT	4
QËLLIMET E HULUMTIMIT	5
HIPOTEZAT	6
METODOLOGJIA E HULUMTIMIT	7
RËNDËSIA E HULUMTIMIT	8
HYRJE.....	9
I. HISTORIKU I SHKOLLËS “VËLLEZËRIT FRASHËRI” NË QYTETIN E LIPJANIT.....	11
1.1 Kushtet e Punës Edukativo - Arsimore.....	12
1.2 Ç’është Procesi i Mësimdhënjes	13
2. ROLI I KOMPJUTERIT NË EDUKIM	14
2.1 Sistemi i Menagjimit të Informacionit në Arsim	16
2.2 Rëndësia e Përdorimit të Kompjuterit në Klasë.....	17
2.3 Efekti i Përdorimit të TIK-ut në Shkollë.....	18
2.4 Roli i Internetit në Shkollë.....	20
3. ZBATIMI I TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT NË SHKOLLËN “VËLLEZËRIT FRASHËRI NË QYTETIN E LIPJANIT.....	22
3.1. Qasja konstruktive e mësuesve në teknologji	26
3.2 Mënyrat e përdorimit të teknologjisë në procesin mësimor, si mjet për arritjen e rezultateve mësimore.....	27
3.3 Përdorimi i teknologjisë së komunikimit si mjet mësimor	30
3.4 Zhvillimi i orës së mësimit duke përdorur teknologjinë	31
3.4.1 Përmbajtja mësimore/akademike	31
3.4.2 Rezultatet e të nxënit, metodologjia dhe procedurat	33
3.4.3 Vlerësimi i të nxënit.....	34
4. AVANSIMI PROFESIONAL I MËSUESVE.....	34

4.1 Planifikimi i një situate mësimi duke përdorur TIK-un	36
4.2 Përdorimi i TIK në Testime	37
4.3 Përdorimi i TIK-ut në Vlerësimin e Performancës së Nxënësve	38
4.4 Përdorimi i TIK-ut në Shkollë për Teste të ndryshme Psikologjike	39
4.5 Përdorimi i TIK-ut dhe E - Learning	39
4.6 Përdorimi i TIK-ut në zhvillimin e të menduarit të nxënësve	40
4.7 Përdorimi i TIK-ut, në zhvillimin e materialit mësimorë	41
4.8 TIK-ut dhe ndikimi i tij në motivimin e nxënësve në mësim	42
5 NDIKIMI I TIK-UT TEK MËSUESIT DHE NË PEDAGOGJI	43
5.1 Ndikimi i TIK-ut në Rolin e Mësuesit	44
5.2 Rregullat e TIK-ut për mësuesit	45
5.3 Rregullat e TIK-ut në mësimdhënie	46
5.4 Aksesit në Informacion	46
5.5 Impakti i TIK –ut në shkolla dhe në sistemet e edukimit	49
5.6 Nevoja për shtim të infrastrukturës teknologjike në shkollë	50
5.6.1 Roli i Harduerëve	51
ANALIZA SWOT E TEKNOLOGJISË INFORMATIVE NË SHKOLLË	52
ANALIZA E PYETSORËVE	54
PËRFUNDIMI	57
Deklaratë e Lektorit	59
REFERENCA	60

LËNDA E HULUMTIMIT

Përdorimi i kompjuterit personal, dhe internetit në shkollë dhe shoqëri ka detyruar një ndryshim të madh pozitiv që kurrë nuk do të kthehet prapa.

Meqenëse informatika, në kohën e sotme, ka depërtuar edhe praktikisht në të gjitha sferat e jetës dhe puës së njerëzve edhe teknologjia para-informative përvetëson hapësira dhe tregje gjithnjë edhe më të mëdha. Do të përmendim vetëm hapsirën e aplikimit të saj vetëm në arsim dhe ndikimin e saj në mësimdhënie dhe mësimnxënje.

Kur mësuesit i përdorin mjetet e teknologjisë në strategjitë mësimore në programin e tyre, nxënësit mund të jenë më të ngazëllyer për të mësuar, qëndrimet e tyre mund të jenë pozitive për teknologjinë, ata mund të angazhohen më shumë në mësim dhe rezultatet e testimit të tyre mund të përmirësohen vazhdimisht.

Integrimi i teknologjisë informative të komunikimit në mësimdhënie dhe nxënie nënkupton përdorimin e kompjuterëve dhe software-ve në mënyrë produktive, shfrytëzimin e internetit dhe përdorimin e rrjeteve kompjuterike për qëllime të mësimdhënies dhe të nxënies, me shembuj konkret në shkollën “Vëllezërit Frashëri”, në qytetin e Lipjanit.

Pajisja e shkollave me kompjuterë ka ndikuar në masë të madhe në përdorimin e drejtë të tij. Mësimdhënësit gjatë orëve mësimore me udhëzimet e tyre dhe me këshilla konkrete kanë mundësi t'i orientojnë nxënësit në përdorimin e drejtë të kompjuterit. Por jo të gjitha shkollat e kanë një mundësi të këtillë. Një numër i konsiderueshëm i tyre kanë vetëm nga një apo dy kompjuterë, të cilët i përdor drejtori i shkollës. Megjithatë, pavarësisht kësaj, mësimdhënësit mund të gjejnë mënyra të ndryshme për integrimin e teknologjisë si mjet pune për nevoja arsimore, qoftë me përdorimin e pajisjeve të tyre personale si laptop, ipad, apo me shfrytëzimin e pajisjeve të kolegëve të tyre.

QËLLIMET E HULUMTIMIT

Qëllimi i këtij studimi është për të determinuar rolin e kompjuterëve , laptopëve , dhe pajisjeve të tjera në shkollën “ Vëllezërit Frashëri “, në qytetin e Lipjanit , dhe ndikimin e tyre në procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies.

- Qëllimi i këtij studimi është të vlerësohet efekti i inkorporimit të TIK-ut në procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies.
- Hulumtimi synon që të realizojë një SWOT analizë (*Strength, Weaknesses, Opportunities and Threats*) të aplikimit të TIK në shkollat fillore të Kosovës.
- Hulumtimi gjithashtu ka për qëllim të identifikojë anët negative të aplikimit të TIK-ut, në shkollat fillore të Kosovës.

Ky hulumtim dhe të dhënat e tij përbëhen nga vëzhgimet në klasë, dhe pyetësorët për nxënës dhe mësues.

Rezultatet e këtij hulumtimi zbuluan se kompjuterët, laptopët dhe pajisjet tjera teknologjike kishin një ndikim pozitiv në sjelljet dhe të mësuarit e nxënësve. Nxënësit ishin në gjendje të krijojnë edhe përmbajtje multimediale dhe i ndajnë ato me botën, gjithashtu marrin pjesë edhe në rrjetet sociale, ku njerëzit nga e gjithë bota ofrojnë ide të dobishme për mësim dhe mësojnë gjëra të reja dhe ndryshimi i atmosferës në klasë ose problemet e disiplinës janë më të pakta dhe barrierat mësues-nxënës ndryshojnë në të mësuarit interaktiv.

Ky hulumtim do të vë në dukje se mësimi interaktiv në mes të nxënësve dhe mësuesve, që përdorin teknologjinë do të ishte i dobishëm në motivimin e nxënësve.

Është evidente se ka mjete të reja të teknologjisë që janë në dispozicion për mësuesit për t'u përdorur në klasat e tyre, ata duhet të inkurajohen vazhdimisht, që zbatimi i teknologjisë të jetë i suksesshëm.

HIPOTEZAT

Teknologjia në arsim është një temë shumë e gjerë dhe shumë pyetje u janë bërë mësime dhe nxënësve për të mbledhur informacione për këtë studim. Studiuesi e ngushtoi temën duke u fokusuar në motivimin, pjesëmarrjen dhe qëndrimin e mësuesve dhe të nxënësve. Si rezultat, ky studim shqyrtoi hipotezat e mëposhtme kërkimore:

Ky studim bazohet në hipotezat e mëposhtme:

- Mësuesit ballafaqohen me probleme me shtimin e teknologjisë në klasat e tyre.
- Mësuesit kanë nevojë për trajnime të mëtutjeshme që të mund të përdorin efektivisht teknologjinë.
- Shkollat ballafaqohen me mungesë të mjeteve të nevojshme teknologjike, softuare-it të përshtatshëm dhe pajisjeve të tjera (përveç kompjuterëve).

Në këtë hulumtim supozohet, që mësime dhe nxënës përdorin strategji mësimore të dëshmuara dhe janë kompetentë në lëndët e tyre, si dhe menaxhimi i tyre në klasë dhe stili mësimor janë tashmë, në cilësi të lartë. Gjithashtu, hulumtuesi supozoi se mësuesit në studim do të përpiqeshin të përfitonin më së miri nga aftësia e tyre për të shtuar mjetet e teknologjisë në kurrikulën e tyre ekzistuese.

Përdorimi i kompjuterëve është inkorporimi i burimeve kompjuterike dhe praktikave të bazuara në teknologji. Në procesin e mësimi me kompjuterë (nxënës marrin vendime se si të bashkëveprojnë dhe përdorin kompjuterin nganjëherë brenda një simulimi ose, loje për zgjidhjen e problemeve mësimore ose përdorin kompjuterin si një mjet për të formuar informacione që duhen).

METODOLOGJIA E HULUMTIMIT

Për të realizuar këtë hulumtim është përdorur kjo metodologji:

- **Metodologjia kuantitative** – do të përdorim pyetësorët që do shpërndahen kundrejt dy grupeve të targetuara: nxënësit dhe ligjëruesit.
 - Do të bëhet edhe një studim në klasë për të vlerësuar statistikisht numrin e pajisjeve, në klasë, software-i i përdorur dhe stafi teknik që menaxhon këto pajisje.
- **Metodologjia krahasuese**– Sistemi arsimor i Kosovës do të ballafaqohet me mungesën infrastrukturës së nevojshme për TIK-un
- **Metodologjia përshkruese** - Do të bëhet një përshkrim kronologjik i reformave në arsim në Kosovë me fokus në aplikimin e TIK-ut në mësimdhënie.

RËNDËSIA E HULUMTIMIT

Shkollat kanë një rol jetësor për të ndihmuar nxënësit e sotëm të kuptojnë, se si vlerat ekzistuese, politikat dhe ligjet që zbatohen në një botë të ndryshueshme dhe me shpejtësi, të varur nga teknologjia.

Ky hulumtim ka rëndësi të veçantë sepse mjetet e teknologjisë mund të sigurojnë një mënyrë tjetër për nxënësit që të flasin dhe të ketë kuptim në botën e tyre. Ato mund të përdoren në mënyra zhvillimore të përshtatshme e që janë të dobishme për nxënësit. Mjetet e teknologjisë nuk zëvendësojnë metodat e tjera të të mësuarit, por shtojnë mjetet që nxënësit të kenë në dispozicion për të eksploruar, krijuar dhe komunikuar. Kur mjetet e teknologjisë përdoren siç duhet nga mësuesit e kualifikuar, ato mund të mbështesin dhe zgjerojnë të mësuarit në mënyra të vlefshme dhe mund të rrisin mundësitë arsimore për të gjithë nxënësit.

Paisja e shkollës me kompjuter dhe rëndësia e tyre në procesin mësimor është i domosdoshëm sepse është një ndër prioritetet kryesore të Ministrisë së Arsimit të Kosovës të paraqitur në Planin Strategjik të Arsimit në Kosovë 2011-2016.

Ky hulumtim fokus kryesor ka studimin e gjendjes në shkollën "Vëllezërit Frashëri" në qytetin e Lipjanit, për mënyrën e integritit të teknologjisë informative në procesin e mësimdhënies dhe të nxënies.

Është kërkuar që të gjendet një mesatare e nxënësve dhe e mësimdhënësve, të cilët integrojnë përdorimin e kompjuterëve, laptopëve, ipadëve në klasat e tyre.

Nxënësit dhe mësimdhënësit janë anketuar përmes pyetësorëve përkitazi me zbatimin e teknologjisë informative për mësimdhënie, si dhe mënyrat e përdorimit të tyre. Ndërsa, analizat e të dhënave të grumbulluara përmes pyetësorëve janë paraqitur në formë kuantitative dhe kualitative.

Politikat arsimore në Kosovë duhet të sigurojnë një vizion afatgjatë, të shpjeguara në objektiva të detajuara në një shkallë të gjërë veprimi, të “zgjerimit të aksesit për të gjithë, rritje të cilësisë së arsimit, riformim i organizimit dhe i menaxhimit të proceseve të arsimit.

HYRJE

Teknologjia ka ndryshuar shoqërinë gjatë gjithë historisë. Gjatë dekadave të fundit, Pajisjet si: celularët e menqur, ipadët, kompjuterët, laptopët dhe më i rëndësishmi interneti kanë ndryshuar tërësisht mënyrën se si njerëzit ndërveprojnë në shoqëri dhe mënyrën, se si punojnë arsimtarët nëpër shkolla.

Është realitet që mësuesit e shekullit XXI të përshtaten me revolucionin teknologjik dhe jonetëm të përgatiten por të përgatisin nxënësit e tyre për botën teknologjike reale. Teknologjia ka ndryshuar mënyrën se si duket shoqëria dhe mënyra se si duket klasa, Arsimi është transformuar për shkak të përdorimit aktual të kompjuterit në klasë. Kompjuterët i ndihmojnë studentët në çfarëdo mënyre që kanë nevojë, duke përfshirë hulumtimin, shtypjen, etj.

Mësuesit gjithashtu përdorin kompjuterë. Ata përdorin kompjuterë për të mbajtur evidencat e tyre klasat, shkruajnë udhëzimet për nxënësit e tyre, angazhojnë nxënësit në klasë dhe qëndrojnë në kontakt me prindërit dhe bashkëpunëtorët.

Një nga ndikimet e mëdha të kompjuterit që ka pasur në shoqëri është mënyra që ka ndërruar ndërveprime shoqërore midis njerëzve. Marrëdhëniet midis njerëzve kanë ndryshuar për shkak të kompjuterëve dhe internetit. Autori Robert Kling propozon, që "mënyrat që njerëzit punojnë dhe komunikojnë përmes rrjeteve kompjuterike destabilizohen shumë kategori të shoqërisë konvencionale".¹ Problemet sociale të paraqitura nga kompjuteri janë të lehta për t'u parë dhe kuptuar.

Arsimi duhet t'u përshtatet ndryshimeve të vazhdueshme të teknologjisë, dhe t'i përdorë ato gjerësisht në procesin mësimor. Këtyre ndryshimeve arsimit duhet t'u përgjigjet, me ritme ë shpejta, me zhvillime të brendshme sasiore e cilësore për të transmetuar njohuri e aftësi sistematike, koherente e të qëndrueshme te nxënësit, duke i reflektuar më pas këto në shoqëri për krijimin e një të ardhmeje më positive për të gjithë.

¹Walter Mathews, *Monster or Messiah?* (Michigan: University Press of Mississippi, 1980), f. 37.

Në epokën e zhvillimit të teknologjisë së informimit dhe komunikimit, përdorimi i kësaj teknologjie gjatë procesit mësimor është bërë një domosdoshmëri për mësuesit. Ky zhvillim lidhet drejtpërsëdrejti me përditësimin e njohurive dhe të aftësive të reja në fushën e edukimit nga mësuesi. Teknologjia ka fuqinë dhe potencialin për të transformuar mjedisin profesional të mësimdhënies. Ajo ndikon mësimdhënien e suksesshme dhe u krijon mundësi mësuesve për të mësuar dhe bashkëpunuar me njëri-tjetrin, nëpërmjet shkëmbimit të ideve e përvojave dhe zgjidhjes së problemeve pedagogjike.

Zhvillimi i shoqërisë informatike paraqet një nga detyrat prioritare të të gjitha qeverive botërore. Nuk ka dyshim se arsimimi është njëri nga segmentet kryesore në nxitjen dhe përkrahjen e zhvillimit të shoqërisë informatike edhe atë në dy aspekte. Pikë së pari, ky segment duhet të jetë promotor i shoqërisë informatike dhe të inicojë krijimin e kuadrove profesionale dhe kompetente, të cilët mund t'ju përgjigjen sfidave të shoqërisë informatike dhe nevojave të ekonomisë së bazuar në dituri. Së dyti, cilësia e procesit edukativo arsimor në mënyrë të drejtë mvaret nga zbatimi i teknologjisë informatike dhe komunikimit në po atë proces.²

² "All About" Computerization. Robert Kling , 1994, 10th & Jordan, Library 012 , Indiana University f3

I. HISTORIKU I SHKOLLËS “VËLLEZËRIT FRASHËRI” NË QYTETIN E LIPJANIT

Në gjysmën e dytë të shek. XIX, saktësisht në vitin 1866 nisin hapat e parë të edukimit dhe arsimimit fillor në Lipjan dhe disa fshatra të komunës. Për një kohë të gjatë mësimi ishte fetar dhe zhvillohej në mejtepe, kryesisht në gjuhën turke dhe arabe.

Mundësitë e shqiptarëve për t'i vijuar mësimet në këto shkolla (mejtepe) ishin tejte të kufizuara, për shkak të gjendjes së rëndë ekonomike të popullatës, mungesës së kuadrit arsimor, mësimi në gjuhën joamtare, mungesës së mjeteve më elementare për punë etj. Këto forma të shkollimit zgjatën deri në fillimin e luftërave Ballkanike, ku atëherë puna e shkollave u rëndua edhe më shumë, kurse në vitin 1915 – gjatë luftës së parë botërore vie deri te ndërprerja e plotë e punës në shkollë. Me përfundimin e luftës së Parë Botërore, saktësisht në vitin 1918 filloi riorganizimi i punës në shkollë. Por, pushteti i atëhershëm nuk ishte i interesuar për shkollimin e fëmijëve shqiptarë dhe lejohej vetëm mësimi në gjuhën serbe. Edhe për kundër kësaj në shkollë u regjistruan edhe disa nxënës shqiptarë. Mësimi zhvillohej nga klasa e parë deri në të katërtën në një shkollë që e kishte ndërtuar pushteti i atëhershëm.

Nga viti në vit, numri i nxënësve sa vinte e rritej, kështu që ishte nevojë e domosdoshme që të ndërtohej një shkollë e re.³

Organet e atëhershme shtetërore (që merrnin tatime të larta nga popullata vendore), në vitin 1925 ndërtuan objektin e ri shkollor me katër dhoma mësimi, me material të fortë ndërtimor dhe që për momentin i plotësonte nevojat dhe standardet për zhvillimin e procesit edukativo – arsimor.

Sipas statistikave të para të udhëhequra në shkollë, në vitin 1936/1937 shkolla kishte katër paralele nga kl. I – IV me gjithësej 172 nx. ku 1/3 e të cilëve, përkatësisht 57 nx. ishin shqiptarë, kurse arsimtarët ishin të përkatësisë serbe.

³<http://vellezheritfrasheri.yolasite.com/>

Karakteristikë e posaçme që ka përcjell shkollën tonë në këtë periudhë është moszgjidhja e çështjes nacionale dhe politika antishqiptare e asaj kohe, e cila ka çuar edhe në trajtimin jo të barabart të nxënësve shqiptarë karshi nxënësve të tjerë.

Kjo bëri që shumë nxënës shqiptarë të mbesin jashtë bankave shkollore.

Me fillimin e luftës së Dytë Botërore , në vitin 1941 ndërpritet puna në shkollë, për të rifilluar në vitin shkollor 1945/46.⁴

Shtimi i vazhdueshëm i numrit të nxënësve që regjistroheshin dhe vijonin mësimet në sh. f. në Lipjan, imponoi nevojën për rregullimin e lokalit shkollor. Kështu në vitin shkollor 1949/1950 u bë ndërtimi i shkollës së re dhe për herë të parë në këtë vit shkollor filloi organizimi i mësimi në gjuhën shqipe, plotësisht i ndarë nga mësimi në gjuhën serbe.

Fillimisht mësimi në gjuhën shqipe zhvillohej si katër klasëshe dhe quhej GJIMNAZI I ULËT OSE PRO- GJIMNAZI.

1.1 Kushtet e Punës Edukativo - Arsimore

Për realizimin e suksesëshëm të rolit dhe funksionit edukativo – arsimor që ka shkolla, kushtet e punës janë ndër parakushtet themelore dhe të domosdoshme.

Për punën normale të një shkolle duhet të sigurohen këto kushte të domosdoshme:

- Lokali i mjaftueshëm për punën normale edukativo – arsimore.
- Kabinetet mësimore.
- Objektet dhe lokalet tjera përcjellëse.
- Ambienti i rregulluar shkollor.
- Baza e mirë materialo- financiare e shkollës.
- Paisja me mjete mësimore bashkëkohore.
- Struktura kualifikuese përkatëse e kuadrit mësimor dhe udhëheqës
- Infrastruktura përkatëse ligjore dhe rregullativa normative e shkollës, si institucion.

⁴<http://vellezeritfrasheri.yolasite.com/>

1.2 Ç'është Procesi i Mësimdhënjes

Mësimdhënja është një proces edukimi që ka lidhje të ngushtë me të mësuarit. Mësimdhënja është një sfidë njerëzore, një përpjekje e paimagjinueshme për t'u dhënë të tjerëve dituri, dhe për t'i bërë njerëzit më të mençur. Mësimdhënja është një ngjarje emocionuese, që të motivon, të frymëzon, e nganjëherë është edhe energjike.⁵

Procesi i mësimdhënjes është i rëndësishëm për arsye të pafundme, por mësimdhënësit duhet të jenë të kompletuar me njohuri të bollshme nga fusha e tyre. Ka mësues që dinë t'i sqarojnë mirë gjërat, ka mësues që i ngatërrojnë gjërat, por ka edhe të atillë që i keq interpretojnë gjërat. Sidoqoftë, mësimdhënja është e rëndësishme, sepse është e ardhmja jonë. Mësuesi, ose mësimdhënësi është një njeri, i cili siguron një edukim apo arsimim të vazhdueshëm për fëmijë ose nxënës të moshave të ndryshme.

Edukimi ose arsimimi është një mjet përmes të cilit njerëz apo grupe njerëzish krijojnë mënyrën e tyre të jetesës përmes qëllimeve dhe zakoneve të tyre nga një brez në tjetrin. Edukimi përmirëson sjelljen humane të njerëzve në shoqëri dhe ndikon pozitivisht në zhvillimin e gjithanshëm të tij. Roli i mësuesit shpesh është formal dhe ai këtë punë e bën në shkollë ose kudo tjetër ku e shih të nevojshme me të vetmin qëllim edukimin e gjithë atyre që kanë nevojë për edukatë.

Sot edukimi është bërë masë e domosdoshme për të gjithë, si për fëmijët ashtu edhe për të rriturit, dhe konsiderojmë se ky është një proces që zgjatë tërë jetën, prandaj do të ishte e pranueshme motoja “edukim për të gjithë” dhe “edukim gjatë tërë jetës”.

Roli i mësuesit mund të ndryshojë në mes të kulturave të ndryshme, që kanë njerëzit në globin e Tokës. Mësuesi mund të japë mësim shkrimi, këndimi, llogaritje numrash, mësim zejtarie, trajnime profesionale, shkathtësi jetësore, artin, kulturën, gjuhët, fenë, drejtësinë, mjekësinë dhe shkathtësi tjera nga përditshmëria.⁶

⁵Kjo tregon se mësuesi dhe nxënësi kanë obligime ndaj njëri tjetrit, i pari të jap njohuri, ndërsa i dyti të marrë njohuri. John a. Lott; “What is Teaching” 2008. f4 .

⁶ Poaty

2 ROLI I KOMPJUTERIT NË EDUKIM

Kompjuterët dhe pajisjet tjera ndihmëse të tij, kanë ndryshuar mënyrën e punës në të gjitha profesionet humane. Prandaj është krejt e natyrshme që teknologjia kompjuterike të aplikohet me të madhe edhe në arsim, prej të cilit process edhe ka dalë kjo teknologji. Kompjuterët sot zbatohen në të gjitha fushat e jetës. Ata ndihmojnë me të madhe në proceset industriale, zbatohen në aplikime medicinale, por aplikimi më i gjerë i tyre është në procesin edukativ.

Tani mësimi i kompjuterit është bërë pjesë e kurrikulave shkollore në tërë botën, si pjesa më e rëndësishme e edukimit modern. Meqenëse sot përdorimi i kompjuterit, bëhet në të gjitha sferat e jetës, atëherë është shumë e rëndësishme për çdo njeri që të marrë së paku njohuritë bazë në fushën e kësaj teknologjie. Kjo është shumë e rëndësishme posaqërisht për arsimtarët e të gjitha drejtimeve shkencore, pra njohja e kompjuterit është e rëndësishme edhe për arsimtarët e gjuhës angleze. Prandaj të shohim në vazhdim se çfarë roli luan kompjuteri dhe teknologjia ndihmëse e tij në fushën e edukimit.

Edhe shfletimi i librave dhe gjetja e informacioneve të duhura shkencore sot është bërë shumë më e shpejtë, përmes kërkimit “search”. Kompjuteri njëkohësisht bën edhe përpunimin e të dhënave me një procedure shumë të shpejtë, si dhe i minimizon gabimet gjatë përpunimit të këtyre të dhënave.

Gjatë përdorimit të internetit hasim edhe në informacione që shpesh janë edhe të pasakta apo edhe të rrejshme. Prandaj ne duhet të kemi kujdes dhe të shfletojmë, e ti referohemi vetëm sajteve zyrtare, apo sajteve të besueshme shkencore. Ruajtja e dokumenteve në kompjuter, bën të mundur që të kursejmë letër, ngjyrë printeri, të kemi akses më të shpejtë në dokumente, si dhe të ruajmë më shumë privacinë dhe autorësinë e dokumenteve apo shkrimeve tona.

Sot kompjuterët janë bërë një mjet i shkëlqyeshëm në ndihmë të mësimdhënjes. Arsimimi online ka revolucionarizuar industrinë e edukimit. Teknologjia kompjuterike ka mundësuar që ëndrra e njerzve për mësim në distancë të bëhet realitet. Sot mësimi i nxënësve dhe studentëve nuk është më i kufizuar në hapsirat e klasës apo amfiteatrit, por ka arritur distancë globale, duke ju falënderuar kompjuterëve, dhe rrjetit të tyre të internetit.

Jemi dëshmitarë të shumë kurseve kombëtare apo ndërkombëtare që mbahen online, ku ata që i ndjekin këto kurse nuk janë fizikisht present në ligjërata, ose i japin testet online nga zyret e tyre. Shembull i kësaj natyre është testi ECDL⁷, që kemi kaluar unë dhe kolegët e mi.

Në ditët e sotme kompjuteri ka arritur të lehtësojë në masë të madhe prezantimin e informacioneve edukative. Programet e njohura si: *PowerPoint, FlashPlayer, Word, Excel, Access, Adobe, etj.* janë bërë ndihmesë e madhe për arsimtarët në mbajtjen e mësimi. Paketa e zyrës, “*MS Office*”, është më shumë se program me qëllim edukimi, i cili ofron një spektër të gjerë mundësish për punë me kompjuter. Ne mund të shkruajmë çfardo teksti në kompjuter pa u brengosur për gabimet gramatikore, sepse programi ka një korrigjues lingustik në çdo gjuhë të botës. Me *Excel dhe Access* ne mund të bëjmë llogaritje, të bëjmë tabela dhe grafike, si dhe të krijojmë databaza për nxënës, me të cilën gjë lehtësojmë punën tonë në menaxhimin e kujdestarisë së klasës.

Jeta jonë sot është e “paimagjinueshme” të bëhet pa kompjuter, prandaj kjo përkufizon fare qartë rëndësinë që ka kompjuteri në procesin e sotëm edukativ. Mund të themi se sot nuk ka kufizime të fushave jetësore ku nuk përdoret kompjuteri. Prandaj nuk do të ishte gabim të themi se aq sa është e nevojshme njohja e gjuhës shqipe apo gjuhës angleze, po aq e nevojshme është edhe njohja e kompjuterit dhe teknologjisë përcjellëse të tij.⁸

Duke punuar me kompjuter jemi bindur se ai është një pajisje shumë e shpejtë në kalkulimin e të dhënave, gjë që bën të mundur kursimin e kohës sonë të çmuar. Siq e dijmë kompjuteri mund të kryejë operacione shumë komplekse matematikore dhe të procesojë informacione kolosale me shpejtësi të sekondës. Kompjuteri shfrytëzohet edhe për të shikuar multimedia, si muzikë, filma, video të ndryshme nga “youtube”, etj. Kompjuterët përkrahin[9] edhe mediumet tjera si CD, DVD, apo mediumet tjera periferike USB, disqet externe, aparatet fotografike, amplifikatorët 3D të zërit, celularët, iPhonët, si dhe me aparatet e ndryshme televizive, përmes të cilave mund të shihen filma nga kompjuteri, në verzionet HD apo 3D.⁹

⁷ Arsimtarët nga e tërë Kosova i janë nënshtruar një kursi për TIK, të quajtur ECDL, ku testet përfundimtare janë organizuar online, nga selia e ECDL në Austri.

⁸ <http://www.buzzle.com/articles/role-of-computers-in-education.html>

⁹ Përkrahin, njohin apo mundësojnë procesimin e përmbajtjeve të CD-ve, DVD-ve, USB-ve, apo disqeve tjera “extern”.

2.1 Sistemi i Menagjimit të Informacionit në Arsim

“Sistemin Informativ të Menaxhimit të Arsimit” është një sistem për organizimin e bazës informative në mënyrë sistematike për menaxhimin dhe zhvillimin arsimor. Sistemi informativ është një qendër informacioni në Ministrinë e Arsimit , Shkencës dhe Teknologjisë në Kosovë , qendra është përgjegjëse për grumbullimin, përpunimin, analizimin , botimin shpërndarjen, dhënien e shërbimeve të informacionit për qështjet e ndryshme rreth arsimit në Kosovë.

Qendra e sistemit të menagjimit informativ e Ministrisë së Arsimit është përgjegjëse për promovimin dhe përdorimin e informacionit brenda ministrisë së arsimit për planifikimin e politikave dhe zbatimin e vendimmarrjes, monitorimin dhe vlerësimin e sistemit të edukimit.

Gjithashtu, është krijuar baza e të dhënave elektronike e arsimit të lartë që përfshin Regjistrin Kombëtar të nxënësve, ku çdo nxënës i regjistruar, në çdo shkollë publike apo private do të ketë numrin e tij kombëtar të identifikimit (matrikulla).

Kjo bazë të dhënash do të përbëhet nga tri module:

- Moduli e Nxënësit;
- Moduli i Shkollës ;
- Moduli Statistikor.¹⁰

Është e rëndësishme të zgjidhjet një mjet i thjeshtë kompjuteri për futjen dhe kontrollin e të dhënave. Edhe në këtë rast, nevojitet trajnimi i personelit, por sidoqoftë, në situata urgjente, është e rëndësishme të preferohet thjeshtësia (duke përdorur për shembull programin kompjuterik të propozuar nga UNESCO).

¹⁰“Education Management Information Systems (EMIS)” f3, Teggegn Nuresu, Wako NESIS/UNESCO November 2003 .

2.2 Rëndësia e Përdorimit të Kompjuterit në Klasë

Teknologjia në arsim është një proces sistematik dhe i organizuar i aplikimit të teknologjisë moderne për të përmirësuar cilësinë e arsimit (eficiencë, optimale, etj.). Është një mënyrë sistematike e konceptimit dhe vlerësimit të procesit arsimor, i. e. të mësuarit dhe mësimdhënies dhe ndihmon në zbatimin e teknikave të mësimdhënies moderne arsimore. Teknologjia përfshin materialet mësimore, metodat dhe organizimin e punës dhe marrëdhëniet, pra sjelljen e të gjithë pjesëmarrësve në procesin arsimor. Fjala teknologji rrjedh nga fjala greke "techno", që do të thotë gatishmëri, shkathtësi, njohuri për mënyrën, sundimin, aftësitë, mjetet dhe "logot", që do të thotë shkencore, fjalë, mësim, dhe gjendje mendore. Vende të ndryshme përdorin terma dhe sinonime të ndryshme si teknologjia arsimore, pajisjet arsimore, teknologjia e mësimdhënies. Dallimet terminologjike janë kryesisht për shkak të qasjes së karakteristikave teknologjike dhe përdorimit të pajisjeve moderne, dhe jo aplikimit të tyre në mësim përkatësisht zbatimi i tyre pedagogjik aktual. Për këtë arsye, ka mendime të ndryshme mes mësuesve në fushën e shkencave sociale dhe teknike. Prandaj, aplikimi i teknologjisë arsimore kërkon njohuri nga disa fusha: pedagogji, psikologji, didaktikë, shkenca kompjuterike, informatikë.

Pajisjet kompjuterike janë veçanërisht të dobishme për nxënësit e ciklit fillor gjatë shkrimit të detyrave duke stimuluar kështu aftësinë e të shkruarit (kompetencën gjuhësore), por kjo ndodh atëherë kur pajisja që përdoret ndërtohet nga një tastierë e plotë shkrimi.¹¹

¹¹ "Pedagoški Leksikon" (1996). Beograd: Zavod za udžbenike i nastavna sredstva f 11

2.3 Efekti i Përdorimit të TIK-ut në Shkollë

Teknologjia mund ta ndihmojë dhe e ndihmon nxënësin të zhvillojë të gjitha llojet e aftësive nga ato më të thjeshtat deri te ato më të ndërlikuarat. Megjithatë, që teknologjia të jetë e suksesshme, mësuesi duhet të bëjë zgjedhje të informuara, në lidhje me qasjen pedagogjike, nevojat e nxënësit dhe rezultatet e të nxënit. Për mësuesin, sa e rëndësishme është të dijë se për çfarë do ta përdorë teknologjinë, po aq e rëndësishme është të dijë dhe mënyrën, se si e nxënja mund të përmirësohet përmes teknologjisë.¹²Integrimi i teknologjisë në klasë nënkupton shumë gjëra për mësues të ndryshëm. Kur, mësuesit pyeten se a e integrojnë teknologjinë në lëndët e tyre ata japin përgjigje të shumta të tilla si:

- a. Nxënësit e përdorin kompjuterin për hulumtuar informacione të ndryshme rreth lëndëve të mësimit.
- b. Nxënësit përdorin word-in për të përpunuar tekstet e detyrave.
- c. Nxënësit e përdorin power –pointin për të bërë prezantime në klasë.

Megjithëse për integrimin e teknologjisë flitet shumë, pak mësues kanë një vizion apo filozofi të qartë për mënyrën e integrimit të saj në kurrikul me qëllim rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe të nxënit.

Mësuesi duhet të jenë sa kompetent në lidhje me dijet, aftësitë dhe qendrimet që ai dëshiron t'u mësojë nxënësve, po aq sa dhe vëzhgues i aftë i mjedisit në të cilin nxënësit ndërtojnë dijet dhe ndërveprojnë me njëri tjetrin. Për këtë qëllim, filozofia e arsimit dhe qasja arsimore luajnë një rol të rëndësishme në kornizën teorike të integrimit të teknologjisë për përmirësimin e orës mësimore.¹³Për t'u siguruar se mjetet e teknologjisë janë përdorur në mënyrë efektive mësuesi duhet t'i përdorë ato nëpërmjet zbatimit të teorive të përshtatshme të mësimdhënies.

Qasja konstruktive me fokus nxënësin në qendër, nxit përfshirjen e nxënësit në procesin e ndërtimit të dijeve dhe kërkon mënyra, që mësuesi të jetë lehtësues në procesin mësimor dhe jo

¹²Brooks, Jacqueline G., and Brooks, Martin G. 1993. In Search of Understanding: The Case for Constructivist Classrooms. Alexandria, VA: Association for Supervision and Curriculum Development f 15 -18

¹³EDUCATION AND URBAN SOCIETY, Vol. 24 No. 4, August 1992 466-476 1992 Children's Television Workshop (New York, New York). f55

të diktojë informacionin. Kjo qasje dukshëm lidhet më mirë me integrimin e teknologjisë. P.sh mësimi zbulues, si një formë e qasjes konstruktiviste inkurajon angazhimin aktiv, nxit motivimin, autonominë, përgjegjshmërinë dhe pavarësinë e nxënësit. Nxënësi udhëzohet nga mësuesi të bashkëveprojë dhe kryejë eksperimente për ta ndihmuar atë të ndërtojë dije dhe aftësi duke u nisur nga dijet dhe aftësitë paraprake.

Detyra e mësuesit është të bashkërendoj informacionin e duhur në një mënyrë të përshtatshme për të ndihmuar nxënësin ta kuptojë atë.

Aktivitetet vizuale me programet kompjuterike mund të jenë komponentë thelbësorë për të ndihmuar nxënësin të shohë, se si konceptet zbatohen në situata reale. Shembulli i përdorimit të teknologjisë janë simulimet nëpërmjet lojërave kompjuterike ku nxënësit luajnë rolin e vendimmarrësit në situata historike në mënyrë që të shikojnë rëndësinë e këtyre ngjarjeve, në jetën e tyre të përditshme dhe të zhvillojnë më mirë aftësitë e të menduarit kritik dhe të zgjidhjes së problemit.¹⁴

¹⁴ Draper, Frank and Mark Swanson. "Learner-Directed Systems Education: A Successful Example," System Dynamics Review, Vol. 6, No. 2. Summer 1990 f17

2.4 Roli i Internetit në Shkollë

Është evidente zhvillimi të shpejtë të rrjeteve kompjuterike, të kapaciteteve të tyre të paimagjinueshme përpunuese dhe përparimeve të skajshme në teknologjinë e ruajtjes së informacionit. Këto zhvillime e kanë bërë kompjuterin një forcë ndë-raktive të pakësimit të distancës dhe të kohës për të arritur nxënësit.¹⁵

Mënyrat e Udhëzimit dhe Mësimit

Përdorimi i kompjuterave individualë në klasë shpesh bie në kategorinë e mësimit të përzier. Ky stil i mësimit është kur mësuesit përfshijnë disa metoda për shpërndarjen e përmbajtjes për studentët. Disa mësues përdorin kompjuterat me nxënës me nevoja të veçanta si mjete për të ndihmuar në kapërcimin e çështjeve të komunikimit. Kompjuterët mund të përdoren për të ndihmuar në ndarjen e detyrave, si dhe për t'u angazhuar në aktivitete të ndryshme, për të siguruar përvojat e komunikimit në kohë reale me të tjerët pavarësisht distancës, rritjes ose zgjerimit të mësimave dhe rritjes së njohurive. Informatika mobile po bëhet një mënyrë popullore e të mësuarit dhe shkollat po përqafojnë teknologjinë jashtë laboratorit kompjuterik dhe në klasë.

Nivelet e Angazhimit në mësim

Kompjuterët individualë në klasë shpesh rrisin nivelin e angazhimit të nxënësit në aktivitet, mësim ose detyrë. Një kompjuter ndihmon fëmijët të përqëndrohen në projektin në dorë dhe mund të jenë një mjet jetik për mbajtjen e interesit të nxënësit në temën e nxjerrë. Shumë studentë janë me të vërtetë të interesuar për teknologjinë moderne dhe natyrisht do të angazhohen dhe marrin pjesë thjesht për shkak se kompjuterët janë në përdorim. Mësuesit mund të rigjallërojnë planet mësimore të mërzitshme që shpejt humbin interesin e fëmijës me kompjuterë dhe teknologjinë moderne. Kompjuterët janë argëtues dhe shumica e studentëve mësojnë dhe mbajnë më shumë kur kanë argëtim gjatë mësimit. Kompjuterët sjellin një element duart në të mësuarit në klasë që është angazhuese dhe stimuluese mendore.

¹⁵http://www.universities.com/Distance_Learning/, shkarkuar në shkurt 2017.

Mundësitë e zgjeruara të të nxënës

Një nga fushat në të cilat teknologjia moderne ka revolucionarizuar botën është komunikimi. Sot, kompjuterët (dhe teknologjia moderne në përgjithësi) e kanë bërë të thjeshtë të bëjnë telefonata jashtë vendit, video chat në kohë reale me njerëz në anën tjetër të globit dhe kanë mundësuar komunikimin që ishte praktikisht e pamundur një shekull më parë. Mësimdhënësit mund t'i sjellin studentët dhe ekspertët e gjallë së bashku përmes lidhjeve virtuale. Klasa e nxënësve të një mësuesi mund të mos jetë në gjendje të hipë në një aeroplan dhe të fluturojë në Antarktidë për një mësim praktik, por ata mund ta shohin zonën praktikisht, përdorin Google Earth për të vrojtuar tokën e akullit dhe flasin me shkencëtarë në kohë reale. Udhëzimet virtuale në terren janë një mjet i shkëlqyer për mësim dhe do të ishte e pamundur pa përdorimin e kompjuterëve në klasë. Sot, fëmijët mund të lidhen me ekspertë në çdo fushë përmes kompjuterave dhe të kenë një kuptim më të plotë dhe më të harmonishëm të mësimave të tyre. Nxënësit mund të bisedojnë me një astronaut, autor ose fizik ose të shohin një ngjarje që përndryshe do të humbnin, thjesht duke pasur akses në kompjuterë në klasë.

Njohuritë për të Ardhmen

Bota po ndryshon me shpejtësi. Risi mund të jetë e vetmja gjë që i paraprin teknologjisë. Zbulimet, shpikjet dhe algoritmet e reja vazhdojnë të marrin shoqërinë në drejtime të reja. Studentët të cilët nuk janë plotësisht të zhytur në revolucionin teknologjik do të jenë të paaftë për të trajtuar botën e ardhshme. Studentët që hyjnë në kolegji pa aftësi kompjuterike janë në një disavantazh të qartë dhe duhet të arrijnë me kolegët e tyre teknologjikisht të aftë. Fëmijët dhe adoleshentët po përdorin kompjuterë dhe teknologji për argëtim, lojra dhe argëtim, por mësuesit dhe administratorët e shkollave nuk duhet të harrojnë përfitimet e tyre arsimore..¹⁶

¹⁶ www.mod.gov.al/botime/html/revista/ shkarkuar në mars 2017.

3 ZBATIMI I TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT NË SHKOLLËN “VËLLEZËRIT FRASHËRI NË QYTETIN E LIPJANIT

Pajisja e shkollës me kompjuterë dhe mënyra e shfrytëzimit të tyre është një faktor që ndikon në bashkëveprimin dhe në bashkëpunimin e nxënësve, prandaj mësuesi duhet të ketë parasysh organizimin e klasave gjatë dizajnimit të aktiviteteve, që realizohen me ndihmën e teknologjisë mësimore. Pasiqë procesi i mësimdhënies, nuk është pranim dhe shpërndarje e diturive, por edhe proces i shumë anshëm, i cili realizohet me aktivitete, si vizatime, këngë, lojë, aktivitete sportive, si dhe përmes Teknologjisë Informative¹⁷. Vendosja e kompjuterëve mund të bëhet në mënyra të ndryshme, duke i vendosur në kabinete të informatikës deri te klasat me një dhe shumë kompjuterët. Në klasat me shumë kompjuterë mund të bëhen më shumë aktivitete grupore. „Klasat me shumë kompjuterë kanë më shumë përparësi se sa një kabinet tradicional i kompjuterëve. Në këtë lloj të klasave, ku monitorët e kompjuterëve janë të futura në tavolina dhe tavolinat të organizuara, në grupe nga tre ose katër, nxënësit mund të shohin më lirshëm njëri-tjetrin dhe mësuesin dhe të komunikojnë më lirshëm. Ndryshe nga kabinetet, nxënësit kanë hapësirë të punojnë pa kompjuterin dhe të përdorin atë vetëm kur u duhet ose nëse u duhet. Në këtë mjedis teknologjia shërben si mjet për të gjitha llojet e ushtrimeve (detyrave), që nga krijimi i faqeve të internetit deri në krijimin e portfoliove personale. Teksa teknologjia vazhdon të udhëheqë të ardhmen e shoqërisë, kompjuterët në klasë janë si një diqka e zakonshme., Çdo shkollë është e ndryshme në lidhje me përdorimin dhe shpeshhtësinë e kompjuterëve, aty ka debate në lidhje me përfitimet dhe rreziqet. Nëse shkollat lejojnë nxënësit të kenë kompjuterë individualë ose të lejojnë kohë në laboratorët kompjuterikë, një gjë është e sigurt: më shumë fëmijë po përdorin kompjuterët në orët jashtë shkollës dhe po bëhen të aftë në teknologjinë moderne.

¹⁷August Vitak “Osnovni problemi vo rabotata na grupi, Beograd, 1964, f57

Tabela 3.1. Paraqet numrin e nxënësve të Shkollës Filllore “Vëllezërit Frashëri” për vitin shkollor 2016-17 sipas klasëve.¹⁸

Lipjani	Shqiptarë			Ashkali			Gjithësejt		
Klasat e I-V	M	F	GJ	M	F	Gj	M	F	GJ
I	62	63	125	/	/	/	62	63	125
II	90	55	145	/	/	/	90	55	145
III	59	54	113	/	/	/	59	54	113
IV	53	53	106	/	/	/	53	53	106
V	65	71	136	/	/	/	65	71	136
Gjithësej Lipjani kl.I-V	329	296	625	/	/	/	329	296	625

Tabela 3.2 Paraqet numrin e nxënësve të Shkollës Filllore “Vëllezërit Frashëri” për vitin shkollor 2016-17 sipas klasëve.

Lipjani	Shqiptarë			Ashkali			Gjithësejt		
Klasat e VI-IX	M	F	GJ	M	F	Gj	M	F	GJ
VI	75	57	132	/	/	/	75	57	132
VII	55	60	115	/	/	/	55	60	115
VIII	66	73	139	/	/	/	66	73	139
IX	56	60	116	/	/	/	56	60	116
Gjithësej Lipjani kl.VI-IX	252	250	502	/	/	/	252	250	502

Tabela 3.3 Paraqet përdorimin e teknologjisë informative sipas lëndëve me përqindje.

¹⁸ Shënime interne nga Shkolla Filllore “Vëllezërit Frashëri”

Përdorimi i teknologjisë informative në lëndët mësimore në %	
Lëndët	Përqindjet
Gjuhë Shqipe	5%
Gjuhë Angleze	10%
Matematikë	5%
Biologji	40%
Fizikë	40%
Kimi	15%
Histori	10%
Gjeografi	30%
Ed. Qytetare	10%
Ed. Muzikore	25%
Ed. Figurative	10%
Teknologji (TIK)	100%
Ed. Fizike	5%

Aplikimi i metodologjive moderne dhe përdorimi i teknologjisë në procesin mësimor ka për qëllim zhvillimin dhe angazhimin, sa më të madh të nxënësve gjatë aktiviteteve të mësimnxënjes dhe përmirësimin e rezultateve mësimore të të nxënësve si dhe rritjen e cilësisë së tërë procesit mësimor.

Në vitet e fundit, kur aplikimet e teknologjisë të tilla, si video projektor, smart board, kompjuterë, software, internet, tableta, mobile etj. janë futur në sistemin e arsimit, burimet për mësimdhënie kanë ndryshuar në mënyrë të konsiderueshme. Metodistët mendojnë, se ka shumë avantazhe të përdorimit të teknologjisë në klasë, si për shembull: ajo e bën nxënësin më të interesuar për temën mësimore, zvogëlon kohën e të mësuarit, si dhe ofron mundësi për të mësuar në mënyrë jotradicionale.¹⁹

¹⁹ David Moursund , “Information and Communication Technology in Education” University of Oregon, 2005, f32

Për të kuptuar rëndësinë e teknologjisë në procesin mësimor shtrojmë pyetjen, se si dhe sa përdorimi i pajisjeve kompjuterike në arsimin fillor dhe arsimin mesëm të ulët do ta stimulonte motivimin e nxënësve për të mësuar, për t'i angazhuar ata gjatë aktiviteteve të mësimdhënies dhe nxënies dhe si e, sa teknologjia do të mbështeste metodat e të nxënësve. Për t'iu përgjigjur kësaj pyetje e cila do të shpjegonte rolin dhe rëndësinë e përdorimit të teknologjisë në procesin mësimor, metodistë të arsimit kanë kryer studime të shumta gjatë të cilave kanë vërejtur se përdorimi i pajisjeve kompjuterike, në klasë paraqet me të vërtetë përfitime të veçanta.

Ata theksojnë, se intervistat me mësuesit, nxënësit, prindërit dhe vëzhgimet në klasë tregojnë se motivimi dhe përqendrimi i nxënësve gjatë aktiviteteve të të nxënësve *rritet*, kur ata përdorin pajisje kompjuterike për t'i përfunduar këto detyra.

Pajisjet kompjuterike janë veçanërisht të dobishme për nxënësit e ciklit fillor gjatë shkrimit të detyrave duke stimuluar kështu aftësinë e të shkruarit (kompetencën gjuhësore), por kjo ndodh atëherë, kur pajisja që përdoret ndërtohet nga një tastierë e plotë shkrimi

Përdorimi i pajisjeve kompjuterike mbështet metodat e të nxënësve për nxënës me aftësi të ndryshme për të nxënë, kështu përdorimi i tyre ndihmon nxënësit me aftësi të ndryshme konceptuale si dhe nxënësit me nevojë të veçanta në përthithjen më të shpejtë të koncepteve të reja gjatë një teme çfarëdo mësimi.²⁰

Përdorimi i teknologjisë në klasë gjithashtu ka një efekt pozitiv në qëndrimet e nxënësve pasi ata ndjehen më të suksesshëm, më të motivuar për të mësuar dhe shfaqin më shumë vetëbesim. Në kohën e sotme digjitale, aftësia për të aksesuar, përshtatur dhe për të krijuar aftësi e dije duke përdorur teknologjinë është kritike për suksesin e nxënësit.²¹

²⁰ What Do Students Gain From Computer Simulation Exercises? An Evaluation of Activities Designed to Develop an Understanding of the Sampling Distribution of a Proportion, Kay Lipson, 2000. F21

²¹ "Role of Technology in Teaching and Learning Statistics", GAIL BURRILL, 1997 , f12

3.1. Qasja konstruktive e mësuesve në teknologji

Përdorimi i teknologjisë dhe qasja konstruktiviste në teknologji, tek mësuesit siguron integrim dhe shfrytëzim më të mirë të mjeteve të teknologjisë në klasë në mënyra të përshtatshme dhe efektive. Përdorimi i teknologjisë në klasë u jep mësuesve dhe anëtarëve të tjerë të shkollës mundësinë për të zhvilluar aftësitë digjitale të tyre..

Integrimi i teknologjisë në arsim ndihmon nxënësit të qëndrojnë të angazhuar. Shumica e nxënësve sot kanë përdorur pajisje të lëvizshme si tableta dhe smartfona për të luajtur dhe për të mësuar, pra, duket logjike që të harmonizohen klasat e sotme me mënyrën se si nxënësit dëshirojnë për të mësuar

Kombinimi i teknologjisë së re si VR (realiteti virtual) me mësimet tradicionale në klasë është një shembull se si futja e teknologjisë së re mund të përmirësojë përvojën e të nxënit dhe të krijojë mundësi të reja.

Kur teknologjia mobile është në dispozicion dhe kryhet në mënyrë të saktë në klasë, studentët janë në gjendje të marrin informacionin më të azhurnuar më shpejt dhe më të lehtë se kurrë më parë. Modeli tradicional i mësimet pasiv është i prishur. Me teknologji në klasë mësuesi bëhet inkurajues, këshilltar dhe trajner.

Teknologjia transformon përvojën e të nxënit. Nxënësit kanë qasje në një sasi të konsiderueshme të mundësive të reja. Nga të mësuarit si të kodosh për të mësuar se si të bashkëpunosh më mirë me ekipet dhe me instruktorët e tyre - teknologjia i aftëson studentët që të jenë më krijues dhe të jenë më të lidhur.²²

²² I.J.Modern Education and Computer Science, 2013, 4, 49-63 Published Online May 2013 in MECS (<http://www.mecs-press.org/>) DOI: 10.5815/ijmecs.2013.04.07.

3.2 Mënyrat e përdorimit të teknologjisë në procesin mësimor, si mjet për arritjen e rezultateve mësimore

Mjetet e punës në internet, siç janë ato në Google Apps, u mundësojnë nxënësve dhe mësuesve të ndajnë dokumentet në internet, t'i editojnë ato në kohë reale dhe t'i projektojnë në një ekran. Kjo u nxënësve një platformë bashkëpunimi për të shkruar ide dhe dokumentuar punën e tyre duke përdorur tekstin dhe imazhet.

Programet e paraqitjes (të tilla si PowerPoint) u mundësojnë instruktorëve të futin fotografi, diagramë, video dhe fotografi të tingullit me rezolucion të lartë për të shtuar tekstin dhe përmbajtjen e ligjëratave.

Tabletat mund të lidhen me kompjuterë, projektorë dhe re, në mënyrë që nxënësit dhe mësuesit të mund të komunikojnë përmes teksteve, vizatimeve dhe diagrameve.

Mjetet e menaxhimit të kurseve të tilla si Canvas lejojnë instruktorët të organizojnë të gjitha burimet që nxënësit kanë nevojë për një klasë (p.sh. programet mësimore, detyrat, leximet, kuizat online), ofrojnë mjete të vlefshme vlerësimi dhe krijojnë hapësira për diskutim, ndarjen e dokumenteve dhe komente audio dhe video. Të gjitha kurset janë dhënë automatikisht një faqe Canvas!

Clickers dhe smartfonët janë një mënyrë e shpejtë dhe e lehtë për të studjuar nxënësit gjatë orës së mësimi.

Instrumentet e mbajtjes së ligjëratave, të tilla si Panopto, u mundësojnë mësuesvetë regjistrojnë leksione direkt nga kompjuteri i tyre, pa pajisje të përpunuara ose shtesë në klasë. Merrni parasysh regjistrimin e leksioneve tuaja si ju jepni dhe pastaj ngarkoni ato për studentët që të rishikojnë. Studimet tregojnë se vendosja e leksioneve të regjistruara nuk zvogëlon pjesëmarrjen dhe studentët e vlerësojnë me të vërtetë mundësinë për të rishikuar ligjëratat me ritmin e tyre.

Tri pyetje ndihmojnë mësuesin për të përcaktuar meritat e teknologjisë në një orë mësimi apo në një situatë të caktuar. Ato janë:

-A është e kreative përmbajtja mësimore? (A janë rezultatet e të nxënësve të qarta, të lidhura me kompetencat kyçe dhe nivelet e arritjes së nxënësve)

- A ka koordinim të ndënësve ne grupe në aktivitetet e caktuara mësimore?

Mësuesi duhet të jenë sa kompetent në lidhje me dijet, aftësitë dhe qendrimet, që ai dëshiron t'u mësojë nxënësve, po aq sa dhe vëzhgues i aftë i mjedisit në të cilin nxënësit ndërtojnë dijet dhe ndërveprojnë me njëri tjetrin. Për këtë qëllim, filozofia e arsimit dhe qasja arsimore luajnë një rol të rëndësishme, në kornizën teorike të integritetit të teknologjisë për përmirësimin e orës mësimore.²³

Për t'u siguruar se mjetet e teknologjisë janë përdorur në mënyrë efektive mësuesi duhet t'i përdorë ato nëpërmjet zbatimit të teorive të përshtatshme të mësimdhënies.

Filozofia e kurrikulës së re, të arsimit bazë është bazuar në qasjen konstruktiviste. Kjo qasje përkufizon: "të mësuarit ndodh kur personi ndërton së bashku mekanizmin për të mësuar dhe versionin e tij unik të dijeve, plotësuar këto me përvojat dhe aftësitë e tij personale" (Roblyer, 2006).

Sipas kësaj qasjeje dija ndërtohet, nuk transmetohet ndaj nxënësi gjeneron dije të reja nëpërmjet aktiviteteve, përvojave dhe eksperimenteve".

Qasja konstruktive me fokus nxënësin në qendër, nxit përfshirjen e nxënësit në procesin e ndërtimit të dijeve dhe kërkon mënyra që mësuesi të jetë lehtësues në procesin mësimor dhe jo të diktojë informacionin. Kjo qasje dukshëm lidhet më mirë me integrimin e teknologjisë. P.sh mësimi zbulues si një formë e qasjes konstruktive inkurajon angazhimin aktiv, nxit motivimin, autonominë, përgjegjshmërinë dhe pavarësinë e nxënësit. Nxënësi udhëzohet nga mësuesi të bashkëveprojë dhe kryejë eksperimente për ta ndihmuar atë të ndërtojë dije dhe aftësi duke u nisur nga dijet dhe aftësitë paraprake.²⁴

Detyra e mësuesit është të bashkërendojë informacionin e duhur në një mënyrë të përshtatshme për të ndihmuar nxënësin ta kuptojë atë. Aktivitetet vizuale me programet kompjuterike mund të

²³ Wenglinksy, "Does it compute? The relationship between educational technology and student achievement in mathematics," Educational Testing Service, Princeton NJ. Policy Information Centre, 1998.

²⁴ B. Means, "Technology and education change: Focus on student learning," Journal of Research on Technology in Education, vol. 42, no. 3, pp. 285-307, 2002. f51

jenë komponentë thelbësorë për të ndihmuar nxënësin të shohë se si konceptet zbatohen në situata reale.

Kjo i jep mundësi nxënësit për të eksploruar mjedise më komplekse. Një shembull i përdorimit të teknologjisë janë simulimet nëpërmjet lojërave kompjuterike ku nxënësit luajnë rolin e vendimmarrësit në situata historike në mënyrë që të shikojnë rëndësinë e këtyre ngjarjeve në jetën e tyre të përditshme dhe të zhvillojnë më mirë aftësitë e të menduari tkritik dhe të zgjidhjes së problemit. Forma të tjera të përdorimit të teknologjisë janë dhe udhëtimet virtuale në kohë. Nxënësit mësojnë rreth kulturave të ndryshme duke parë fotografi, filma, videoklipe, prezantime në power-point dhe tekste të përzgjedhura. Nxënësit, gjatë navigimit nëpërdhëtimin virtual, u përgjigjen pyetjeve të mësuesit.²⁵

Mësimdhënia e bazuar në teknologji mund të thellojë mësimin e nxënësve duke mbështetur objektivat mësimore. Megjithatë, mund të jetë sfiduese për të zgjedhur mjetet "më të mira" të teknologjisë, duke mos humbur synimet tuaja për të mësuarit e nxënësve. Sapo të identifikohet, integrimi i këtyre mjeteve vetë mund të jetë një sfidë, megjithëse një eksperiencë e hapjes së syve.

CTL është këtu për t'ju ndihmuar (rishtar, ekspertë dhe të gjithë në mes) të gjejnë mënyra kreative dhe konstruktive për të integruar teknologjinë në klasën tuaj. Nëse po kërkonit të rrokni klasën tuaj, përdorni kanavacën ose thjesht dëshironi të eksperimentoni me disa teknologji të reja mësimore, ne mund t'ju ndihmojmë.

²⁵ L. M. O'Dwyer, M. Russell, D. Bebell, and K. R. Tucker-Seeley, "Examining the relationship between home and school computer use and students' English/language arts test scores," *Journal of Technology, Learning, and Assessment*, vol. 3, no. 3, 2005. F20 - 24

3.3 Përdorimi i teknologjisë së komunikimit si mjet mësimor

Qasja konstruktiviste përfshin komunikimin e informacionit nga mësuesi te nxënësi, nga nxënësi te mësuesi, nga nxënësi tek nxënësi. Teknologjitë e komunikimit janë mjete elektronike, të cilat përdorin kompjuterin dhe internetin përtë bërë të mundur shkëmbimin e shpejtë të informacionit ndërmjet njerëzve. Komunikimi elektronik përfshin lloje të ndryshme të shkëmbimeve të informacionit.²⁶

Mjetet që mësuesit mund ti përdorin gjatë orës së mësimit janë të tilla si:

- ***Posta Elektronike***
- ***Website i Klasës*** është faqe interneti që ndërtohet nga mësuesi për të paraqitur orë mësimi dhe për të komunikuar informacione për nxënësit, prindërit, shkollën dhe personelin arsimor.
- ***Bloge*** (ditar/lajme) janë revista/ditar publike online të aksesueshme shkruar nga individë (si mësues) për të tjerët (si nxënës, prindër dhe mësues të tjerë) për tu lexuar dhe komentuar prej tyre.
- ***Bisedat online*** janë forume elektronike ku mësuesit dhe nxënësit diskutojnë për çështje të ndryshme arsimore. Diskutimet online janë komponent i zakonshëm i blog-eve dhe websiteve të mësuesve.

²⁶ K. S. Shapley, C. Maloney, and F. CaranikasWalker, "Evaluating the implementation fidelity of technology immersion and its relationship with student achievement," *Journal of Technology, Learning, and Assessment*, vol. 9, no. 4, pp. 1-2, 2010.

3.4 Zhvillimi i orës së mësimi duke përdorur teknologjinë

Me zhvillimin e teknologjisë, aftësitë arsimore po rriten dhe po ndryshojnë çdo ditë. Interneti ka arritur të bëhet një bibliotekë e madhe elektronike e informacionit, dhe të dy hulumtimet dhe udhëzimet mund të arrihen me një klik të miut. Me këto përparime vijnë përgjegjësi të reja ndaj mësuesve dhe për këtë arsye rrisin vlerën e tyre . Teksa përparon teknologjia, aftësitë e një edukatori do të rriten me hapa të mëdhenj dhe pa dijeninë e këtyre ndryshimeve dhe aftësive, mësuesi ka një shans të mirë për t'u lënë pas.

Një karrierë në arsim kërkon punë të madhe dhe përkushtim, por, për edukatorin e zellshëm, mund të provojë shumë shpërblim. Për ata që janë serioz për suksesin në fushën e arsimit, qëndrimi i mirë i informuar për teknologjitë aktuale dhe ndryshuese është imperativ. Ndërsa bota e teknologjisë evoluon, mjedisi i të mësuarit, si në kampus ashtu dhe në internet, do të përparojë në mënyrë të barabartë, dhe nevojat e mësuesve që janë të trajnuar në teknologji do të vazhdojnë të rriten .²⁷

3.4.1 Përmbajtja mësimore/akademike

TIK është i fuqishëm në paraqitjen ose përfaqësimin e informacionit në mënyra të ndryshme. Kjo mund të bëhet përmes formave të ndryshme (tekst dhe fotografi ose tabela dhe grafika) ose duke mundësuar që ndryshimet të shfaqen në mënyrë dinamike, të tilla si në modelimin matematikor ose duke ndihmuar vizualizimin e proceseve komplekse në shkencë.

Informacioni mund të manipulohet lehtë në një kompjuter në mënyrë që një nxënës të mund të bëjë ndryshime dhe të vlerësojë efektin e këtyre ndryshimeve. Kjo mund të jetë aty ku informacioni është i llojit të njëjtë si teksti në përpunimin e fjalëve ose numrat në fletët e ose ku është në forma të ndryshme të tilla si midis tabelave dhe tekstit .

²⁷ Young, Rose, Using Technology Tools in the Public School Classroom, December, 2008, f15

Vëzhgimi i ndryshimeve në një grafik kur bëhen ndryshime në tabelën e informacionit numerik mbi të cilin bazohet grafiku ose duke manipuluar një formulë algjebrike dhe duke parë se si një grafik i atij funksioni ndryshon në një kompjuter ose llogaritës grafik mund të zhvillojë kuptimin e nxënësve për marrëdhëniet matematikore .

Mjetet kompjuterike mund t'i ndihmojnë studentët ose mësuesit të manipulojnë me të dhëna të ndërlikuara. Kjo siguron një kontekst për një diskutim efektiv i cili nga ana tjetër mund të ndihmojë në zhvillimin e të kuptuarit matematikor . 'Veglat e vizualizimit' mund t'i ndihmojnë nxënësit të përshkruajnë idetë shkencore ose të zhvillojnë kuptueshmërinë konceptuale.

Megjithatë, mund të jetë e rëndësishme që të mos mësohen aftësitë në izolim. Prezantimi i multimedias në formën e librave të folur është treguar të përmirësojë lexuesit fillestarë vetëdijes fonologjike, por pa përmirësuar njohjen e tyre të fjalës. Një interpretim i kësaj mund të jetë që fëmijët të përmirësohen më mirë në lojë kompjuterike (siç e shohin), por aftësitë e përmirësuara nuk mund të përdoren lehtë nga kompjuteri.

Përfitimet mund të vijnë vetëm kur përmirësimi specifik mbështetet me të mësuarit e tjerë në kompjuter ose që lidhet me mësimin e larguar nga kompjuteri dhe madje edhe atëherë çdo përmirësim mund të jetë i shkurtër. ²⁸

²⁸ Rebecca Cartwright, Ken Weiner, and Samantha Streamer-Veneruso Revised May, 2010, Student Learning Outcomes (SLO) f 31.

3.4.2 Rezultatet e të nxënit, metodologjia dhe procedurat

Rezultatet e të nxënit janë arsyeja pse një mësim po mësohet.

Metodat janë strategji të ndryshme mësimore për grupe të vogla apo të mëdha nxënësish që mësuesit përdorin për të përcjellë përmbajtjen/mësimore akademike për nxënësit. Metoda më të shpeshta që mësuesit përdorin gjatë orës së mësimi janë: diskutimi, loja me role, simulimi, studim rasti, aktivitete të bazuara në hetim, shkrimi kreativ, mësimi reflektues, ushtrime, lojëra.

Procedurat janë aktivitete të planifikuara nga ana e mësuesit për t'u zhvilluar gjatë një ose mësimi, duke përfshirë dhe grupimin e nxënësve dhe se sa kohë merr çdo aktivitet për t'u zhvilluar.

Mësuesit kombinojnë rezultatet e të nxënit, metodat, dhe procedurat në formatet e tyre tëplanifikimit ditor. Ndonjëherë përmbajtja kurrikulare dikton këto procese, ndonjëherë rezultatet e të nxënit, metodat dhe procedurat diktojnë zgjedhjen e përmbajtjes. Por, mund të themi që përmbajtja, rezultatet e të nxënit, metodat dhe procedurat reciprokisht mbështesin njëra-tjetrën në një proces dinamik të zhvillimit të orës së mësimi, ku teknologjia mbështet në mënyra të ndryshme këtë proces. Teknologjitë më të shumta që mbështesin procesin e të nxënit janë:

- *Softwari për prezantime të ndryshme psh (Microsoft Power Point)*
- *Web-me për krijimit të diagrameve*
- *Faqe interneti të administruara nga mësuesit*
- *Posta elektronike*
- *Link-e, blogje dhe wikis*
- *Software interaktivë*
- *Sisteme inteligjente për mësimdhënie*
- *Kamera digjitale dhe software për filma)*
- *Teknologji ndihmëse* ²⁹

²⁹ Rebecca Cartwright, Ken Weiner, and Samantha Streamer-Veneruso Revised May, 2010, Student Learning Outcomes (SLO) f 31.

3.4.3 Vlerësimi i të nxënit

Vlerësimi i mësimdhënies/nxënies (rezultateve të të nxënit) ndodh para, gjatë, dhe pas mësimdhënies/nxënies duke ndihmuar mësuesin të vlerësojë, se sa janë arritur rezultatet e të nxënit përcaktuar për atë orë mësimore nëpërmjet vlerësimit të performancës së nxënësve. Vlerësimi mund të jetë përmbledhës (përmbledh atë që nxënësit kanë mësuar në fund të një ore mësimi), formues (ndodh gjatë gjithë kohës) ose diagnostikues (i paraprin një mësimi si një mënyrë për të matur atë që nxënësi paraprakisht dinë)

Mjetet e teknologjisë që mbështesin procesin e vlerësimit dhe vlerësimin e nxënësve janë:

- a. *Provime elektronike dhe kuiz-e*
- b. *Portofoloi personale digjitale*
- c. *Rubrika vlerësimi online*
- d. *Anketa të ndryshme online*³⁰

4 AVANSIMI PROFESIONAL I MËSUESVE

Integrimi i TIK-ut në procesin mësimor nuk kufizohet thjesht me instalimin e rrjetit dhe pajisjeve kompjuterike që lidhen në të. Ai përfshin përdorimin e gjitha teknologjive që ofrojnë këto pajisje në shkollë për të përmirësuar mësimdhënien dhe për të lehtësuar mësimnxënien, në këtë proces.

Njohuritë bazë që duhet të zotërojnë mësuesi i shekullit të 21-të përfshijnë edhe përdorimin e teknologjive të informimit dhe komunikimit e, veçanërisht, kompjuterin dhe web-teknologjitë, metodologji në procesin mësimor. Këto metodologji ofrojnë një mjedis dhe një qasje më efektive në procesin mësimor. Sipas shumë autorëve të huaj dhe vendas, përdorimi i TIK-ut, në procesin mësimor ka ndryshuar jo vetëm metodat e mësimdhënies, po edhe ato të mësimnxënies.

³⁰ Amrein, A. L., & Berliner, D. C. (2002). High-stakes testing, uncertainty, and student learning. Educational Policy Analysis Archives, 10(18). Available at www.epaa.asu.edu/epaa/v10n18.

Integrimi i përdorimit të TIK-ut në programet shkollore sjell ndryshime në cilësinë e procesit mësimor. Në dokumentet e reja kurrikulare të hartuara në kuadër të rishikimit të kurrikulës aktuale për sistemin tonë arsimor, kompetenca digjitale 2 është një ndër shtatë kompetencat kyçe të kurrikulës. Kjo kompetencë nënkupton aftësinë për përdorimin kritik dhe efektiv të TIK-ut në punë dhe gjatë kohës së lirë. Ajo bazohet në shkathtësimin e përdorimit të kompjuterit për të gjetur, prodhuar, krijuar, prezantuar dhe shkëmbyer informacion, si dhe për të bashkëpunuar në rrjetet informuese në internet.³¹

Aplikimi i TIK-ut në klasë ofron rritjen e cilësisë së mësimdhënies. Roli i mësuesit tashmë synon të ndryshojë nga ajo e përcësimit të njohurive në atë të ndërtuesit të njohurive, trajnerit, dhe krijuesit të mjediseve mësimore të ngjashme me ato të situatave reale.³²

Për të kryer operacionet bazë me hardware dhe software si dhe aplikimet e menaxhimit të informacionit mësuesit duhet :

- Të përshkruajë dhe demonstrojë përdorimin e tipeve të ndryshme të hardware-eve, kompjuterëve, laptopëve, printerave, skanerave dhe pajisjeve portabël;
- Të demonstrojë funksionet bazë dhe të përdorë Microsoft Word ; të përshkruajë dhe demonstrojë qëllimin dhe cilësitë kryesore të software-ve të prezantimit dhe resurseve të tjerë digjitale;
- Të përshkruajë qëllimin dhe funksionimin e software-eve grafike dhe të përdorë një paketë software-ike grafike;
- Të përshkruajë Internet-in dhe World Wide Web, si dhe të tregojë si funksionon një browserpsh : Internet Explorer , Chrome , Mozilla Firefox etj
- Të përdorë një motor kërkimi (search engine) psh Google, Aol, etj. Dhe të demonstrojë kërkimin e website-eve;
- Të krijojë një llogari e-mail-i dhe ta përdorë atë; psh: Hotmail, Gmail, Yahoo etj.

³¹ D. Bullock, "Moving from theory to practice: An examination of the factors that pre-service teachers encounter as they attempt to gain experience teaching with technology during field placement experiences," Journal of Technology and Teacher Education, vol. 12, no. 2, f. 211- 224, 2004

³² A. Bowman, "Infusing technology-based instructional frameworks in the methods courses: A response to Pope and Golub," Contemporary Issues in Technology and Teacher Education, vol. 1, no. 1, .f 98-101, 2000.

- Të përshkruajë funksionimin e një software-i ose një pakete (software packages) mbi një fushë specifike ;
- Të lokalizojë dhe skedojë paketat software-ike të edukimit dhe t'i vlerësojë ato për nga saktësia dhe përputhja me kurrikulën shkollore;³³

4.1 Planifikimi i një situate mësimi duke përdorur TIK-un

Për planifikimin e situatave të nxënies duke përdorur teknologjinë, mësuesit mund të përdorin ilustrime/demonstrime të ngjashme me ato të botës reale gjatë mësimdhënies. Në shkollat tona kemi dy kategorive mësuesish:

- a) Mësues që kanë njohuri fillestare të domosdoshme për përdorimin e kompjuterit dhe Internetit
- b) Mësues të avancuar në përdorimin e kompjuterit dhe Internetit duke përfshirë këtu edhe njohuri nga programimi në gjuhën Java ose minimalisht në gjuhën C++ (ka shumë ngjashmëri midis gjuhës Java dhe asaj C++).

Për kategorinë a) të mësuesve, do të këshillojmë që: Së pari, në përshtatje me tematikën e mësimi që duan të ilustrojnë, mësuesit duhet të bëjnë një kërkim në Internet me fjalë kyçe “tema e mësimi (anglisht) + Java Applet ose Visualization”. Pasi është më i përshtatshëm për temën që trajtojnë. Pastaj ato duhet të shkarkojnë (download) faqen lokalisht, duke shkarkuar jo vetëm skedarin (faqen) .htm ose html, por edhe të gjithë skedarët që linkohen në faqe. Në veçanti, duhet shkarkuar edhe skedari i applet-it (nëse ka të tillë) *emri, class*.

Pasi provon nëse faqja hapet lokalisht (duke shkëputur kompjuterin nga Interneti), e hap atë dhe shikon me “View Page Source” (komanda varet nga lloji i browser-it që përdoret) faqen burimemri.html, e cila është një skedar i formatit ASCII (thjesht tekst-pa simbole apo formula). Ky skedar editohet me anë të aplikimit “Notepad” ose “Wordpad”. Teksti i faqes html

³³ K. Dawson, C. Cavanaugh, and A. Ritzhaupt, “Florida’s EETT Leveraging Laptops Initiative and its impact on teaching practices,” University of North Carolina at Wilmington, vol. 41, no. 2, pp. 143-159, 2008.

është shkruar në gjuhën HTML, pra me komanda që shkruhen brenda etiketave. Për të përshtatur tekstin në shqip, mjafton të zëvendësohet teksti anglisht me atë shqip, por gjithnjë në modën ASCII.

Ndryshimet e kryera ruhen dhe pastaj rishfaqet me anë të browser-it skedari i ndryshuar. Në këtë rast, figurat, formulat dhe vetë Applet-i nuk modifikohen, pra ato do të shfaqen me simbolet/tekstet brenda tyre siç janë në origjinal.³⁴

4.2 Përdorimi i TIK në Testime

Vëzhgimet e zakonshme tregojnë se cilësia e mësimdhënies në klasë është në rënje. Ka nxënës që nuk i kuptojnë disa koncepte të caktuara. Kjo mund të vlerësohet duke futur testet (diagnozen), në procesin mësimor, për të kuptuar sa këto koncepte janë kuptuar nga nxënësit. Kjo nuk është, se përdoret shumë, arsyeja mund të jetë klasa me shumë nxënës, nuk ka teste diagnostikuese në lëndë të ndryshme, mungesa e trajnimeve dhe dëshires së mësuesve etj.

Kjo vështirësi mund të kalohet më lehtë me ndihmën e TIK. Testet diagnostiko kompjuterike punojnë mirë dhe ndihmojnë mësuesit si dhe nxënësit për të identifikuar zonat gri të çdo nxënësi. Këto mund të vendosen në vebite të shkollës dhe nxënësit mund të hyjnë në këto teste nga shtëpia gjithashtu. Nxënësi mund të përgatitet për temën/kapitullin dhe mund të bëjë testin për të gjetur saktësisht atë, që ai nuk ka kuptuar. Progresi i nxënësit mund të monitorohet dhe performanca e tij mund të përmiresohet. Kjo mund të zhvillojë besimin e nxënësve dhe mund të ndryshojë qëndrimin e tij ndaj kësaj lënde. Nxënësit mund të fillojnë ta duan të mësuarit.³⁵

Më poshtë janë përparësitë kryesore të testeve kompjuterike diagnostikuese

- Ato nuk kërkojnë ndonjë mjedis të veçantë. Kërkesa e vetme është sistemi kompjuterik dhe softëare-i
- Nxënësit mund ta përdorin atë edhe në shtëpi, nëse kanë akses në vebite- in e shkollës.

³⁴ Danikhel, G.: Developing Instructional Material for Improving Reading Skills amongst School Students. Ph.D. (Edu.), Devi Ahilya University, 1998 f21

³⁵ Davis, F. D., Bagozzi, R. P., and Warshaw, P. R. (1989). User acceptance of computer technology: A comparison of two theoretical models. Management Science, 35(8), 982-1003.

- Ata nuk kanë nevojë për ndonjë ndihmë të veçantë nga mësuesi. Ndryshe nga testet në letër ajo nuk kërkon korrigjimin nga ana e mësuesit.
- Kjo kursen kohë për mësuesit dhe nxënësit
- Rezultati jepet menjëherë pasi testi është përfunduar, i cili i jep një forcim të brëndshëm nxënësit.
- Për nxënësin është më interesant dhe motivues se testet në letër
- Ajo mund të azhurohet nga koha në kohë³⁶

Kufizimet në përdorimin e testeve kompjuterike përfshijnë këto qështje :

- Nxënësit nuk e marrin atë, aq seriozisht sa testin në letër.
- Përdorimi i testeve kompjuterike kërkon shumë kompjuter, të cilët nuk janë në dispozicion në shumë shkolla
- Nxënësit që nuk janë shumë miqësor me kompjuterë mund të mos ndihen rehat kur e japin testin në kompjuter.
- Disa probleme teknike mund të ndërpresin kryerjen e testit
- Mësuesit mund të mos jenë të gjithë të trajnuar për zhvillimin e këtyre testeve ose mund të mos njohin gjuhët kompjuterike.

4.3 Përdorimi i TIK-ut në Vlerësimin e Performancës së Nxënësve

TIK-ut mund të përdoret për të vlerësuar. Janë ndërtuar softëare-e të ndryshëm të cilët vlerësojnë të kuptuarit e nxënësve. Testi mund të përdoret në mënyrë individuale nga nxënësi për të vlerësuar të mësuarit e tij. Nxënësit mund të marrin menjëherë feedback në lidhje me statusin e tij të të kuptuarit. Nëse përgjigjja është gabim, ai mund të marrë përgjigjen e saktë. Kjo është

³⁶ Thurlow, M., Lazarus, S. S., Albus, D., & Hodgson, J. (2010). Computer-based testing: Practices and considerations (Synthesis Report 78). Minneapolis, MN: University of Minnesota, National Center on Educational Outcomes.

një mënyrë për të përmirësuar të mësuarit dhe mësuesi nuk ka ndonjë rol për të luajtur në këtë rast. Testet mund të ngarkohen në vebite për një përdorim më të gjërë. Nxënësit nga shkolla të tjera mund ti përdorin këto teste. Kështu TIK-ut mund të përdoret të përmirësuar cilësinë të mësuarit.³⁷

4.4 Përdorimi i TIK-ut në Shkollë për Teste të ndryshme Psikologjike

Ekzistojnë diferenca individuale. Përmes kërkimit janë studiuar disa korrigjime të arritjeve akademike. Rrallë ky informacion është përdorur nga mësuesit e shkollave. Shumë prej tyre as nuk kanë dijeni rreth këtyre kërkimeve. Edhe nëse kanë dijeni ata nuk e përdorin atë në kohën e formimit të grupeve në aktivitete të ndryshme shkollore. Një nga arsyet kryesore është që shkollat nuk kanë një psikolog të trajnuar i cili mund ti ndaj nxënësit në disa nga këto ndarje të arritjeve akademike. Për më tepër, testimi psikologjik është i lodhshëm dhe kërkon para dhe kohë. Madje edhe testet e përshtatshme psikologjike nuk janë të përdorshëm. Kjo është epoka e teknologjisë dixhitale. Kjo mund të përdoret për të dixhitalizuar të gjitha testet psikologjike përfshirë rezultatin dhe vlerësimin. E njëjta gjë mund të jetë e disponueshme në website dhe nxënësit e mësuesit mund t'i përdorin ato kurdo që kërkohet. Gjithashtu nxënësit mund t'i përdorin ato në mënyrë individuale dhe mund të ndajnë rezultatin me mësuesin i cili mund ti ndihmoj ata të përmirësojnë performancën akademike. Testet e dixhitalizuara psikologjike do të jenë të thjeshtë për tu përdorur dhe gjithashtu ekonomike. Kështu që TIK-ut mund të përdoret në testet psikologjike gjithashtu.³⁸

4.5 Përdorimi i TIK-ut dhe E - Learning

Teknologjia digjitale ka thyer kufijtë mes shteteve. Njerëzit nuk ndejnë asnjë lloj kufizimi në komunikimin me njerëz nga e gjithë bota. Aksesimi është bërë i lehtë. Është një fakt i njohur që të gjithë studentet nuk i kuptojnë të gjitha lëndët në të njëjtën masë. Disa nxënës kanë vështirësi

³⁷ Ertmer, P. (2005). Teacher pedagogical beliefs: The final frontier in our quest for technology integration. Educational Technology, Research and Development, 53(4) 25-40.

³⁸ Athanasios Drigas Leyteris ,KoukianakisYannis Papagerasimou , Conference Paper ,Part of the Lecture Notes in Computer Science Book Series (LNCS, volume 5288) 2008 f88-95

në disa lëndë si Matematika, Fizika, Anglishtja, Kimia etj. Shumë shkolla nuk kanë laboratore të përshtatshëm edhe mundësi që t'ju bëjnë orë shtesë për ato lëndë që nxënësit kanë vështirësi. Rrjedhimisht nxënësit e ndjejnë nevojën e mbështetjes akademike jashtë shkollës. Kështu që ata kërkojnë mësues privat.³⁹

4.6 Përdorimi i TIK-ut në zhvillimin e të menduarit të nxënësve

Teknologjitë e reja janë më afër qasjes së aftësive të të menduarit. Mjediset interaktive eksploruese lejojnë nxënësit që të drejtojnë të mësuarit e tyre me anë të zbulimeve dhe procesit të udhëhequr të kërkimeve. Këto teknologji ndihmojnë për të bërë më të qartë të menduarit dhe ju mundëson nxënësve të paraqesin hipoteza, të eksperimentojnë dhe të marrin një feedback të menjëhershëm, të diskutojnë dhe të reflektojnë lirshëm me bashkëmoshatarë të tyre. Janë të disponueshme shumë aplikacione softëare-e të cilat mund të përdoren në lëndë të ndryshme siç është Geometry Sketchpad që eksploron marrëdhëniet gjeometrike, ThinkerTools për të mësuar ligjet e lëvizjes dhe të forcës, Stella për sistemin e të menduarit etj. Të gjithë këto softëare kanë, si qëllim kalimin nga një mjedis tradicional me laps dhe letër në një mjedis dinamik të të mësuarit. Duke përdorur këta softëare nxënësit mund të eksplorojnë shembuj të panumërt shpejtë dhe lehtë. Duke përdorur softëare të tillë klasa kalon nga një mjedis me në qendër mësuesin në një mjedis me në qendër nxënësin. Nxënësit, në këtë mjedis kanë ndjenjën e kontrollit mbi të mësuarit e tyre. Natyra e këtyre programeve i bën nxënësit që të përmirësojnë angazhimin e tyre në materialin e dhënë. Është e rëndësishme që për të mos rënë interesi i nxënësve programe të tilla të kombinohen edhe me të mësuarit tradicional, pra këto programe të shërbejnë si një mjet për të plotësuar të mësuarit tradicional dhe jo si instrumenti kryesor i mësimdhënies.⁴⁰

³⁹ Trow M. (1970). "Reflections on the Transition from Mass to Universal Higher Education". In Daedalus vol 99. Winter 1970: The Embattled University f. 1-42

⁴⁰ Wang, X. (2012). "An exploration of Biggs' Constructive Alignment in Course Design and its Impact on Students' Learning Approaches". Assessment and Evaluation in Higher Education, f. 1-15

4.7 Përdorimi i TIK-ut, në zhvillimin e materialit mësimorë

Aktualisht ka një mungese të mësuesve të kualifikuar dhe kompetent në të gjitha lëndët dhe në të gjitha nivelet. Jo vetëm kjo, madje edhe përmbajtja mësimore në disa libra nuk është cilësore, dhe shumë shpesh informacioni është gabim. Leximi i librit nuk është shumë i këndshëm për nxënësit dhe shpesh nuk i ndihmon nxënësit në kuptimin e koncepteve dhe mbajtjen mend të informacionit. Do ishte e rëndësishme, që mësuesi ta dixhitalizonte materialin mësimorë dhe ta vinte në dispozicion të nxënësve. TIK-ut është shumë e fuqishme, në prezantimin e informacionit në disa menyra. Kjo do të rriste cilësinë e mësimdhënies në klasë.⁴¹

Avantazhet e përdorimit të TIK-ut në mësimdhënie janë:

- Ka rëndësi të madhe në kërkime dhe hulumtime.
- Rrit aftësitë vërtetuese dhe investiguese.
- Ofron një mësimdhënie më të thjeshtë, të shpejtë dhe efektive.
- Mundëson shtrirjen dhe eksplorimin në një gamë më të gjerë informacioni dhe materialesh.
- Ofron barazi mbi zgjedhjet dhe qasjet e informacioneve, duke mundësuar p.sh edhe nxënësit e zonave rurale të kenë informacione mjaft të vlefshme në mësimdhënie.
- Ofron mbështetje karshi nxënësve.
- Përmirëson motivimin, sjelljen dhe interesin ndaj mësimi.
- I ndihmon nxënësit në përqendrim, në të kuptuarit më mirë dhe ruajtjen e informacionit.
- Kontribuon në ndërtimin e një kulture të përbashkët për të gjithë nxënësit.

⁴¹ Wang, X. (2012). "An exploration of Biggs' Constructive Alignment in Course Design and its Impact on Students' Learning Approaches". *Assessment and Evaluation in Higher Education* f. 19

4.8 TIK-ut dhe ndikimi i tij në motivimin e nxënësve në mësim

TIK ka një impakt jo vetëm mbi atë që nxënësit duhet të mësojnë, por ajo luan një rol të madhë në mënyrën se si nxënësit duhet të mësojnë. Është shumë e rëndësishme që kurrikulat kalojnë nga forma “mësuesi në qendër” tek forma “nxënësi, në qendër”. TIK-ut siguron motivim për të mësuar. Teknologjitë e informacionit dhe komunikimit (TIK) të tilla, si televizioni, video-t dhe softëare-ët multimedial që kombinojnë tekstin, muzikën dhe animacionet shumëngjyreshe mund të përdoren për të sigurur përmbajtje sfiduese (nxitese) që do të angazhojë nxënësit në procesin e të mësuarit. Po ashtu radiot interaktive që përdorin efektin e zërit, këngët, skeçet komike, bisedat etj, e bëjnë, e detyrojnë nxënësin të dëgjojë dhe të bëhet më i përfshirë në mësim. Në disa studime, që janë bërë në vende të tjera dhe janë anketuar prindërit e disa nxënësve, ata kanë theksuar se fëmijët e tyre janë ndjerë më të motivuar në një orë mësim, i kur përdoren mjete të tilla teknologjike që u përmenden më sipër, se sa në një orë tipike tradicionale, ku mësuesi flet gjatë 45 minutave dhe nxënësit vetëm dëgjojnë. Mësuesi nuk duhet të jetë vetëm” përçues i dijes”, se sa “udhëheqës” në procesin mësimorë.

Mësuesit mund ta bëjnë shpjegimin e temës më tërheqës dhe të gjallë duke përdorur multimedialë dhe nga ana tjetër nxënësit do ta kenë më të lehtë për ta përvetësuar këtë temë. ⁴²

Nëse ora e mësimit bëhet interesante për nxënësit, atëherë edhe njohuritë që ata marrin do të ruhen për një kohë të gjatë në mendjen e tyre.

⁴² Kozma, R. (2005), 'National Policies That Connect ICT-Based Education Reform To Economic And Social Development', Human Technology Vol.1, No. (2), f; 117-156

5 NDIKIMI I TIK-UT TEK MËSUESIT DHE NË PEDAGOGJI

Mësuesit janë një komponent i rëndësishëm në mjedisin e të mësuarit dhe për këtë arsye ndikimi i TIK-ut mbi mësuesit dhe strategjitë që ata përdorin për të lehtësuar mjedisin e të mësuarit janë kritike. Kjo nganjëherë duket si supozim se përdorimi i TIK-ut në procesin mësimorë kërkon ndryshim për të gjithë mësuesit, ndonëse disa mësues kanë krijuar mjedise të përshtatshme të të mësuarit për vite më rradhë pa përdorur TIK-ut. Megjithatë, këta mësues kanë tendencën për të përdorur TIK-ut, sepse ata e perceptojnë lehtësisht se duke vepruar kështu ata mund të ofrojnë një mjedis akoma më të mirë për të mësuar.

Ndikimi mbi mësuesit mund të jetë i larmishëm, ndër më kryesoret janë këto:

- Vlerësimi i roleve të mësuesit
- Siguron një akses më të mirë të informacionit, duke çuar në rritjen e interesit në mësimdhënie dhe eksperimentime.
- Kërkon më shumë bashkëpunim dhe komunikim si me mësuesit e tjerë ashtu edhe me prindërit.
- Kërkon më shumë planifikim dhe energji
- Kërkon zhvillimin e aftësive dhe njohurive mbi TIK-un
- Siguron më shumë kohë për t'u angazhuar me nxënësit, duke çuar në produktivitet më të madhe.

Ndërsa impakti mbi pedagogjinë mund të përmblihet sipas këtyre strategjive, që janë:

- Më shumë nxënësi në qendër (të mësuarit me në qendër nxënësin)
- Më shumë bashkëpunim dhe punë në grupe
- Mësim më aktiv⁴³

⁴³ Brown, J. D. Computers in language testing: Present research and some future. 1997. f.37

5.1 Ndikimi i TIK-ut në Rolin e Mësuesit

Lidhja mes zhvillimit të teknologjisë dhe transformimit të arsimit është e qartë nga ana historike. Edhe modeli i mësimdhënies dhe të nxënësve bazuar në tekst është në vetvete një produkt i futjes së një teknologjie të re, që është shtypshkronja (në shekullin e 16 në Europë). Pyetja është, si shkollat do të adaptojnë dhe aplikojnë teknologjinë, dhe çfarë modelesh të mësimdhënies dhe të nxënësve do të rezultojnë. Deri tani nuk është se teknologjia po luan ndonjë rol të rëndësishëm në procesin mësimor për shkak të ndikimit që kanë metodat tradicionale të të mësuarit dhe rutinës, që mësuesit praktikojnë. Pavarësisht këtyre, shumë elemente të shkollës tradicionale do të mbeten pavarësisht potencialit që ka përdorimi i teknologjisë. Mësuesi gjithmonë do të duhet të jetë udhëheqës i nxënësve, pasi njeriu ka nevojë të ndërveprojë dhe të motivohet nga njeriu. Ndërkohë që është e qartë se roli i mësuesit do të vazhdojë të jetë kritik, përbërja e këtij roli ka gjasa të ndryshojë, të kërkojë një gamë më të gjerë aftësish dhe të kuptuarit. Mësuesit duhet të jenë më të aftë në drejtimin e nxënësve drejt shfrytëzimit të një sasive të madhe dhe të pasur informacionin. Nxënësit kanë nevojë për udhëheqjen dhe vlerësimin e mësuesve të kualifikuar. Ndikimi mbi strategjitë e mësimdhënies do të çojë në ndryshime në përbërjen e rolit të mësuesit. Për shembull, qasja në një nivel të lartë të kompjuterëve, që mbështesin mësimin, tenton të inkurajojë mësuesit për të përdorur më shumë punën në grupe dhe më pak mësues që thjeshtë mbajnë një leksion. ⁴⁴

Për mësuesit që duan të lehtësojnë përdorimin e kompjuterëve ka dy grupe të gjera detyrash:

1. *Integrimi i aplikacioneve kompjuterike në programet mësimore dhe kurrikul*
2. *Zbatimi në klasë që përfshin menaxhimin e mjedisit të klasës: rolet, sjelljet, materialet.*

45

Në integrimin e aplikacioneve kompjuterike në programet mësimore mësuesit duhet të bëjnë aplikacionin kuptimplotë për nxënësit. Një nga rolet e mësuesit në këtë është të ndihmojë nxënësit të interpretojnë përvojat e tyre. Kjo mund të argumentohet me faktin se kompjuterët lejonë një eksplorim ose eksperiencë shumë më të pasur, por kërkojnë një nivel më të lartë të kompetencës nga ana e mësuesit për t'i lejuar nxënësit, që të përftojnë plotësisht nga kjo eksperiencë. Mësuesit duhet të kenë aftësi për të iniciuar, organizuar dhe vlerësuar, dhe shpesh

⁴⁴ Sivakova, D. Ndikimi i teknologjisë së informacionit dhe komunikimit në përmirësimin e mësimin, Bitola, 2007. f.

86

⁴⁵ Poaty

duhet të jenë të përgatitur për të ndryshuar, ndonëse ende janë kritik në përdorimin e teknologjive siç është kompjuteri.

Pra, mësuesit duhet të zhvillojnë aftësitë për të gjykuar nëse një softëare i veçantë do të ofrojë mësimin që pretendonte dhe nëse ky mësim është i përshtatshëm për klasën e tyre dhe programin mësimorë.

Për mësuesin ekziston risku i humbjes së ndikimit të tij themelor mbi vlerat dhe drejtimin e veprimtarisë në klasë. Disa mësues shqetësohen mbi rolin dhe influencën që do të kenë në klasë.

5.2 Rregullat e TIK-ut për mësuesit

Shoqata ndërkombëtare për teknologjinë e edukimit (ISTE) dhe UNESCO kanë përgatitur paketa standardesh të TIK-ut për mësuesit. Këto paketa standardesh janë hartuar për shtetet, rajonet, shkollat dhe institucionet e arsimit për të lehtësuar dhe për të mundësuar integrimin e teknologjisë, në programet e lëndëve të ndryshme, bazuar tashmë, në standarde të njëjta ndërkombëtare. Për t'iu përgjigjur ndryshimeve dhe sfidave të kohës për një mësimdhënie moderne dhe për ta vendosur sistemin arsimor shqiptar përkrah sistemeve arsimore europiane është i domosdoshëm hartimi i standardeve të TIK-ut për mësuesit. Standardet e TIK-ut për mësuesit kanë për qëllim të përcaktojnë konceptet, njohuritë, aftësitë që duhet të këtë mësuesi për zbatimin dhe integrimin e teknologjisë në procesin mësimor⁴⁶

Mësuesit trajnohen:

1. Për të marrë informacion dhe njohuri nga burime të ndryshme.
2. Për përpunim dhe shkëmbim njohurish.
3. Për përdorim të pajisjeve dhe platformave teknologjike, në shërbim të përmirësimit të mësimdhënies.
4. Për shfrytëzimin e shumëllojshmërisë së formave të TIK-ut.
5. Për aftësim dhe cilësi në punë.

Integrimi me sukses i TIK-ut në klasë varet nga aftësia e mësuesve për të strukturuar mjedisin e të nxënësve në mënyrë që nxënësit të aftësohen për të marrë dije të qëndrueshme, për t'i thelluar

⁴⁶ UNESCO. Broshura 4: "Të krijojmë mjedise gjithëpërfshirëse e mësimdashëse. Të pranojmë diversitetin": Manual për krijimin e mjediseve gjithëpërfshirëse e mësimdashëse. Bangkok, 2004.

këto dije dhe për të krijuar dije të reja. Vendosja e standardeve të TIK-ut për mësuesit do t'i ndërgjegjësojë ata, në lidhje me mënyrën dhe domosdoshmërinë e përdorimit të TIK-ut në mësimdhënie/nxënie.

5.3 Rregullat e TIK-ut në mësimdhënie

Me hartimin e standardeve të TIK-ut në mësimdhënie synohet të harrihet në këto objektiva:

1. *Të sigurohet trajnimi i mësuesve të të gjitha cikleve për përdorimin e teknologjisë.*
2. *Të përmirësohet arsimimi i mësuesve me standardet e duhura për të zbatuar teknologjitë e reja bazë TIK-un gjatë gjithë procesit mësimor.*
3. *Të rritet aftësia sociale dhe komunikuese e mësuesve.*
4. *Të bëhen mësuesit përdorues të rrjeteve për të shkëmbyer informacione, për bashkëpunime mes kolegësh dhe ekspertësh të jashtëm duke nxitur zhvillim profesional të tyre.*
5. *Të përdorin mësuesit programe kompjuterike për prezantime të ndryshme.*
6. *Të njohin dhe të përdorin mësuesit internetin si burim informacioni.*
7. *Të njohin mësuesit metodat interaktive multimediale gjatë procesit mësimor.⁴⁷*

5.4 Aksesimi në Informacion

Sasia e informacionit në botë është gjithnjë në rritje. Për mësuesit dhe nxënësit kjo do të thotë, që **së pari** ka më shumë dije dhe **së dyti** është e rëndësishme të jenë në gjëndje të analizojnë informacionin me efikasitet. Sistemet kompjuterike sigurojnë mjete për mbledhjen e informacionit, organizimin e informacionit, përpunimin e informacionit dhe komunikimin e informacionit. Nxënësit dhe mësuesit tani duhet të mësojnë të përdorin këto mjetet në mënyrë efektive. Edukatorët, gjithashtu duhet të jenë të shqetësuar në lidhje me vlefshmërinë e shumë informacioneve që janë në dispozicion në Internet.

⁴⁷ UNESCO. Broshura 4: "Të krijojmë mjedise gjithëpërfshirëse e mësimdashëse. Të pranojmë diversitetin": Manual për krijimin e mjedisve gjithëpërfshirëse e mësimdashëse. Bangkok, 2004.

Për shkak se është relativisht e lehtë dhe e lirë për të shpërndarë informacion duke përdorur internetin, secili mund ta bëjë këtë pa u vlerësuar informacioni nga dikush tjetër. Kështu që, mësuesit duhet të nxisin tek nxënësit idenë e analizimit të informacionit që po përdorin dhe marrjes në konsideratë të vlefshmërisë së burimit të informacionit, që ata marrin duke përdorur internetin. Ata duhet të marrin në konsideratë, se kush është përgjegjësi që ofron këtë informacion dhe pse ky informacion është bërë i disponueshëm. Për shembull, informacioni i dhënë nga një agjenci qeveritare duhet të trajtohet ndryshe nga ajo që ofrohet nga një organizatë biznesi ose që ofrohet nga një universitet.

TIK-ut i jep mundësi mësuesit për të gjetur informacion që mbështet përpjekjet e tyre për strategji të reja, për të reflektuar mbi teknikat, që ai përdor në procesin mësimorë, për tu angazhuar në gjetjen e materialeve të reja etj, në prezantimin e informacionit në mënyrë, që mësimdhënia të bëhet sa më interesante, në gjetjen e ilustrimeve apo ushtrimeve shtesë për një temë të caktuar etj. Planifikimi i përvojave mësimore që përfshijnë përdorimin e kompjuterave në klasë merr kohë të konsiderueshme dhe kërkon burime dhe planifikime komplekse. Prandaj, mësuesit që përdorin kompjuterët, në klasë nuk duhet të punojnë të izoluar nga njëri-tjetri. Ata duhet të shkëmbejnë idetë, materialet dhe përvojat që ata kanë pasur me klasat e tyre, gjatë përdorimit TIK-ut në procesin mësimorë. Ndërsa, për shumë mësues implementimi i kompjuterëve mund të kërkojë ndryshime në qëndrimet dhe praktikat e klasës, për shumicën e mësuesve ka një numër të aftësive praktike të cilat duhet ti zhvillojnë. Janë aftësi kompjuterike dhe aftësi të menaxhimit të klasës të cilat paraqesin një pengesë për një numër mësuesish. Mësuesit kanë nevojë që tu jepet mundësi për të bashkëvepruar dhe për tu familjarizuar me teknologjinë. Në shumë raste mësuesit zhvillojnë aftësitë e tyre kompjuterike gjatë përdorimit të kompjuterit personal, ata pastaj janë në gjëndje për të zbatuar dhe suportuar aplikacionet në klasë.

Tabela më poshtë përmbledh implikimet e mundshme për mësuesit me arsyet e mundshme për përdorimin e kompjuterave në klasë. Implikimet të cilat do të rezultojnë në avantazhe me mësuesit janë shënuar me *. Nga këndvështrimi i mësuesve ka të ngjarë të jenë më shumë disavantazhe ose vështirësi se sa avantazhe. Ndërsa, kompjuterët mund të shihen të kenë potencial të madhë në arsim, në të njëjtën kohë ata i prezantojnë mësuesit disa pengesa të tjera për tu kapërcyer. Kështu që, shumica e përfitimeve të mundshme drejtohen drejt nxënësve në përmirësimin e të mësuarit. Shumë pak përfitimime janë të drejtuar drejt detyrave të mësuesve në

klasë. Potenciali i kompjuterave lidhet me qëllimet dhe objektivat të cilat mësuesi i vendosë për atë klasë.⁴⁸

Potenciali i kompjutereave	Ndërlikime për mësuesit
Të mësuarit dinamik	Nxënësit mund të mësojnë jashtë zonës së ekspertizës së mësuesit. Më e veshtirë për të drejtuar dhe menaxhuar të mësuarit e nxënësve.
Motivimi i nxënësve	Nxënësit janë më të lehtë për tu menaxhuar dhe drejtuar drejt detyrave. * Nxënësi mund të jetë i hutuar nga kompjuteri dhe nuk përqëndrohet në detyrën që ka dhënë mësuesi.
Të mësuarit në përshtatje me nxënësit	Lehtëson mësuesin nga nevoja për të shpenzuar më shumë kohë me nxënësit që kanë nevojë për praktikë shtese, apo për nxënësit që kanë nevojë për përforcim të njohurive *
Të mësuarit e pavarur	Mësimi mund të mos drejtohet vetëm drejt objektivave të mësuesit. Koordinimet plotësuese të nxënësve dhe materialeve janë të nevojshme në klasë.
Zgjerimi i të menduarit të nxënësve	Të menduarit e nxënësve mund të shkojë përtej përvojës apo aftësive teknologjike të mësuesve, kjo mund të ulë besimin tek mësuesi.

Mësuesit duhet të punojnë vazhdimisht në përditësimin e aftësive dhe njohurive të tyre në operimin dhe përdorimin e TIK-ut. Prandaj është shumë e rëndësishme që mësuesit të përkrahen në mënyrë shumë të kujdesëshme nga ana praktike dhe motivuese nëpërmjet trajnimeve të ndyrshme që mund të bëhen në lidhje me përdorimin e TIK-ut.

⁴⁸Sansanëal, D.N.: Information Technology and Higher Education. UNIVERSITY NEËS, Vol. 38, No. 46, 2006.

5.5 Impakti i TIK –ut në shkolla dhe në sistemet e edukimit

Shkollat dhe sistemet arsimore duhet të sigurojnë infrastrukturën dhe përkrahjen për nxënësit dhe mësuesit, si dhe të mirëmbajnë mjediset (klasat) në të cilën është përdorur TIK-ut. Në të njëjtën kohë mjetet e TIK-u do të ndihmojnë shkollat dhe sistemin arsimore në krijimin e mjediseve sa më të pasura për nxënësit dhe mësuesit. Megjithatë ka një numër problemesh të rëndësishme që pengojnë dhe parandalojnë mësuesit nga arritja e plotë e avantazheve, që ofrohen nga aplikacionet kompjuterike.

Kërkimet kanë dhënë disa kërkesa për përdorimin efektiv të TIK-ut, në arsim.

- Përshtatja e teknologjisë me standardet e arsimit
- Mbështetja e programeve
- Sigurimi i qasjes të teknologjisë së përshtatshme
- Sigurimi i mbështetjes administrative për përdorimin e teknologjisë.
- Siguron kohën për mësuesit për të planifikuar dhe mësuar se si të integrojnë teknologjinë
- Sigurim i mbështetjes së vazhdueshme teknike për përdorimin e teknologjisë.

Në përgjithësi këto kërkesa i përkasin këtyre fushave:

- Sigurimit të infrastrukturës hardware dhe software
- Sigurimit të kurrikulës dhe mbështetjes teknike për mësuesit
- Organizimi, qëllimi, politikat dhe praktikat e shkollës
- Shkollimi

Niveli i efektivitetit të teknologjisë në arsim ndikohet nga nxënësit, softëare-t, roli i mësuesit, si dhe niveli i qasjes së nxënësve në teknologji. Është e qartë që me rolin kritik që ka mësuesi në procesin mësimor, sistemi arsimor duhet të marrë parasysh së pari nevojat e mësuesve. Problemet e mësuesve që kanë me kompjuterat mund të shikohen në aspektin e aksesit në infrastrukturën e përshtatshme, dhe mundësive për të mbështetur zbatimin e kësaj infrastrukture.⁴⁹

⁴⁹Scardamalia, M. & Bereiter, C. (1994). Computer support for knowledge-building communities. The Journal of the Learning Sciences, 3, 265–283.

5.6 Nevoja për shtim të infrastrukturës teknologjike në shkollë

Kërkesat e infrastrukturës mund të shikohen në aspektin e burimeve elektronike, hardëare, përdoruesve . Përdorimi i hardwarë-ve të papërshtatshëm, mungesa e programeve të dobishme dhe vështirësitë për të fituar aksesin e duhur në sistemet kompjuterike janë vërejtur si pengesat kryesore në përdorimin e kompjuterëve nga ana e mësuesve dhe nxënësve. Zgjedhja dhe shpërndarja e hardëare-ve dhe softëare-ve është vendimtare për suksesin e përdorimit të kompjuterit në shkollë. Me vendosjen e kompjuterëve në kurrikulën, shkolla ka nevojë të marrë në konsideratë krijimin nëse mund të thuhet kështu të një bibliotekë me softëare në gjëndje për të mbështetur mësuesit e të gjitha lëndëve. Disa paketa softëare janë më të lehta për tu përfshirë në programin mësimor se sa disa të tjera që mund të kërkojnë një shkallë përgatitje dhe përfshirje nga ana e mësuesit. Kur mësuesi planifikon mënyrat në të cilat kompjuteri mund të përdoret, kjo ka të ngjarë që përdorimi i tij do të bëhet më i zbatueshëm në program dhe më i dobishëm për mësuesin dhe nxënësit. Por mësuesit që janë të pafamiljarizuar me përdorimin e kompjuterit ndoshta do të preferojnë metodat tradicionale ose të përdorin ndonjë softëare që nuk kërkon shumë planifikim siç është përshembull word ose power-point. Përzgjedhja e programeve softëare duhet të plotësojnë nevojat e stafit, si dhe të studentëve.

Nëse, qëllimi i shkollës është që nxënësit të orientohen drejt përvojave mësimore atëherë nxënësit duhet t'i ofrohen grupe të gjëra burimesh, të cilat janë të mundshme duke përdorur kryesisht burimet elektronike. Këto burime mund të përbëhen nga dosje të dhënash (informacione) dhe aplikacione softëare (programesh), që mund të shpërndahen online apo në CD. Prandaj shkolla dhe sistemi arsimor duhet t'u japë mësuesve dhe nxënësve akses të gatshëm dhe të lehtë për këto burime.⁵⁰

Gjithnjë e më shumë kjo qasje do të jetë online, sidomos për dosjet e të dhënave (data files), dhe duke qënë se ka një sasi të madhe burimesh informacioni, lindin dy probleme të mëdha:

- Përdorimi i burimet të cilësisë së lartë
- Zgjedhja e burimeve të përshtatshme.

⁵⁰ Coley, R. J., Cradler, J. &Engel, P. K. (1997). Computers and Classrooms ,f54

Problemi i dytë vijon nga i pari nëse softëare-t e cilësisë së mire do të përdoren, në klasë. Kjo përfshin vlerësimin për t'u siguruar që ai është projektuar mirë dhe, së dyti për të përcaktuar kur duhet të përdoret në klasë. Në mënyrë tipike mësuesit nuk kanë kohë për të vlerësuar programin dhe shpesh heqin dorë nga përdorimi i tij. Është shumë e rëndësishme, që mësuesit të komunikojnë me njëri-tjetrin e pse jo edhe me mësues jashtë vendit duke përdorur internetin për të ndarë përvojat e tyre dhe për të ndihmuar njëri-tjetrin për të zgjedhur programin e duhur.

5.6.1 Roli i Harduerëve

Është e rëndësishme që nxënësit të kenë qasjen e duhur në paisjet e përshtatshme hardware. Shumica e programeve softëare kërkojnë, që nxënësit të punojnë në kompjutera individualë, pasi arritja e rezultateve të rëndësishme varet nga sasia e paisjeve kompjuterike që janë në dispozicion për përdorim nga nxënësit. Duke qenë se kompjuterat kushtojnë, është e vështirë, që nxënësit të kenë një numër të përshtatshëm kompjuterash në shkollë. Po ashtu duke qenë se teknologjia kompjuterike vazhdimisht është në përmirësim, e bën më të vështirë sigurimin e hardëare-ve të përshtatshëm për nxënësit. Shkollat gjithashtu përpiqen për përsosmëri në mësimdhënie. Si të tilla, ato përdorin teknika dhe pajisje për t'i ndihmuar nxënësit në ngritjen e cilësisë së tyre dhe efektivitetit të mësimin. Në një masë më të vogël, nxënësit e konsiderojnë harduerin si një mjet i rëndësishëm në mësim. Në këndvështrimin afatgjatë, ka një interes në rritje për teknologjinë për kursimet e saj në numrin e mësuesve të punësuar. Kjo kosto të teknologjisë shtohen në barrën ekonomike të shkollës dhe justifikohen për arsye se përmirësojnë cilësinë e mësimdhënies, motivimin e nxënësve dhe prestigjin e shkollës, administratën dhe komunitetin.⁵¹

⁵¹ Learning with Technology. 1998 ASCD Yearbook. Alexandria, VA: Association for Supervision and Curriculum Development. 199–215.

ANALIZA SWOT E TEKNOLOGJISË INFORMATIVE NË SHKOLLË

Analiza SWOT përdorimit të TIK-ut në situatën aktuale në Shkollën Filllore “Vëllezërit Frashëri” në Lipjan

Pikat e forta

- Rritja e efikasitetit të mësimit
- Më shumë fleksibilitet i kohës, ritmit dhe vendit të mësimit
- Përmirësimi i cilësisë së procesit pedagogjik
- Ofertë e zgjeruar dhe e pasuruar e materialeve të ndryshme të mësimit
- Zhvillimi i aftësive dhe njohurive të reja (për shembull - rritja e njohurive sipër të përdorur TIK-në në pajisjet moderne)

Dobësitë

- Nxënësit nuk kanë paisje të përshtatshme (si Ipad).
- Disa mësues kanë njohuri të pakta për përdorimin e TIK-ut.
- Ngarkesa e konsiderueshme e profesorëve dhe mungesa e kohës.
- Prezantimi i TIK-ut, si rezultat i nismës individuale jo gjithmonë të mbështetur sistematikisht nga udhëheqja e institucionit.

Mundësitë

- Rritja e mundësisë për trajnimin për grupe të caktuara të mësuesve.
- Mundësi për inovacione dhe hulumtime të vazhdueshme në procesin pedagogjik.
- Zhvillimi profesional i profesorëve dhe personelit tjetër nga literatura.
- Mundësi për të pasuruar furnizimin e programit studimor duke ofruar module të cikleve të ndryshme.
- mundësi për t'u përfshirë në projektet ndërkombëtare dhe në procesin e globalizimit sipartner në kushte të barabarta.

Kërcënimet

- Nevojitet rregullimi i skemës financiare, stafit dhe aspekteve tjera organizative
- Përshtatja e infrastrukturës teknologjike të nevojshme
- Paragjykimet dhe keqkuptimet e përdorimit të TIK-ut në procesin pedagogjik.
- Personeli nuk është i trajnuar mjaftueshëm për përdorimin e TIK-ut dhe metodave didaktike moderne
- Njohje e papërshtatshme e inovacionit, hulumtimit dhe përdorimit të TIK-ut, në fushën pedagogjike.

52

⁵² Analizë e shkurtër e situatës aktuale dhe të aktiviteteve mësimore që kanë lidhje me TIK-un , e bazuar në Shkollën Fillore “ Vëllezërit Frashëri në Lipjan , Janar , 2018

ANALIZA E PYETSORËVE

Kjo anketë u zhvillua nga Ekrem Salihu , student në profilin master në Universitetin e Evropës Juglindore në Tetovë.

Qëllimi i anketës në katër shkollat e anketuara ishte se sa e përdornin Tik në mësim , dhe a ishin të pajisur me infrastrukturën përcjellse teknologjike .

E rëndësishme : administratori i pyetësorit garanton plotësisht anonimatën e informacionit personal.

<i>Shkollat e Anketuara</i>	Numri i Kompjuterëve	Numri i Laptopve	Numri i Printerëve	Numri i Projektorëve
Shkolla Fillore Hazan Z. Kamberi	10	1	2	2
Sh. F . Ismail Luma	16	5	5	5
Sh. F. Vëllezërit Frashëri	17	8	4	8
Sh. F. Zenel Hajdini	20	1	1	1

Pyetësi për mësimdhënës

- Qëllimi i këtij pyetësi është, që të marrin mendimin tuaj se sa ju si mësimdhënës e përdorni kompjuterin dhe internetin gjatë mësimdhënies.
- Ne ju sigurojmë që informacionet që ju jepni nuk do të keqpërdoren.

Si plotësohet pyetësi

- Pyetësi plotësohet duke iu përgjigjur çdo pyetjeje. Kërkojmë nga ju që mos të anashkalohet asnjë pyetje pa u përgjigjur, pyetjet janë me alternative.
- Ju lutem rrethoni vetëm njërin nga alternativat.

Lënda të cilën e ligjëroni: _____

1. Sipas jush zbatimi i teknikave bashkëkohore në mësimdhënie ndikon në mësimnxënie më të lehtë të lëndës:

a) Shumë b) Mesatarisht c) Pak d) Aspak e) Nuk mund të përgjigjem
2. A keni qenë pjesëmarres në trajnime të ndryshme të organizuara që kanë pasur për qëllim ta mësoni përdorimin e veglave kompjuterike në mësimdhënie:

a) Po b) Jo
3. Cilën nga format e punës e përdorni më shumë me nxënës gjatë orës mësimore:

a) Frontale b) Në dyshe c) Në grup
4. A e përdorni internetin gjatë ligjërimit në lëndën tuaj:

a) Shumë b) Ndonjëherë c) Asnjëherë
5. A e përdorni E-Mail për të komunikuar me nxënës për mësim:

a) Po b) Jo
6. A e përdorni facebook-un për të komunikuar me nxënës për mësim:

a) Po b) Jo
7. Cilin prej programeve mendoni se më shumë ju ndihmon gjatë ligjërimit:

a) Excel b) PowerPoint c) Word d) Asnjërin

8. A mendoni se përdorimi i internetit ju ndihmon nxënësve në tema të caktuara:

- a) Po b) Jo

9. A jeni të knaqur me angazhimin e nxënësve gjatë orës mësimore:

- a) Shumë b) Mesatarisht c) Pak d) Aspak

Pyetje të shtuara nga unë:

10. A mendoni se keni nevojë për trajnime të mëtutjeshme në lidhje me përdorimin e veglave kompjuterike në mësimdhënje?

11. Mendoni se kompjuterët në klasë e lehtësojnë punën tuaj?

12. Sipas jush, çfarë nga të posht përmendurat i mungojnë shkollës tuaj (rretho më tepër):

- a. Interneti
- b. Kompjuterë modern
- c. Nxemja
- d. Uji
- e. Librat
- f. Rryma
- g. Bankat
- h. Karriket

13. Cili është web shfletuesi të cilin e përdorni më tepër:

- a. Chrome
- b. Firefox
- c. Internet Explorer
- d. Opera
- e. Tjetër _____

14. Çfarë sistemi operativ përdorni:

- a. Windows
- b. Linux
- c. MacOS
- d. Android

PËRFUNDIMI

Qëllimi i këtij hulumtimi ishte edhe dhënia e informacionit për gjetjen e vështirësive që mësuesit hasën në përdorimin e TIK-ut në procesin mësimor. Gjetjet e këtij studimi tregojnë se mësuesit kanë një dëshirë të fortë për integrimin e TIK në arsim, por ata hasën shumë pengesa në të. Këto gjetje tregojnë që nuk ka implikime për trajnimin e mësuesve për t'u bërë përdorues të rregullt të TIK-ut sidomos duke u fokusuar në marrjen e aftësive themelore të IT-së. Burimet e TIK-ut, përfshirë softuerët dhe pajisjet, zhvillimi efektiv profesional, koha e mjaftueshme, trajnimi i duhur dhe mbështetja teknike janë domosdoshmëri që duhet t'u ofrohen mësuesve.

Ky punim diplome ka për qëllim të tregojë, që sot në shekullin XXI, Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit (TIK) është element kyq në zhvillimin e procesit mësimor dhe të paraqesi disa nga format më të përshtatshme dhe më të përhapura që mund të përdoren në arsim. Trajnimi i mësuesve në çështjet pedagogjike duhet të rritet dhe mësuesit duhet të binden për vlerën e përdorimit të TIK-ut në procesin mësimor.

Shkollat duhet të shfrytëzojnë përfitimet e TIK-ut në procedurat dhe praktikatat e tyre të vlerësimit përtej funksioneve administrative.

Kjo mund të përfshijë përdorimin e TIK-ut për të vlerësuar progresin e nxënësve përmes përdorimit të softuerëve të përshtatshëm.

Studimi zbulon se shumë mësues kishin aftësi në përdorimin e kompjuterëve në klasë, por ende përdorin shumë pak teknologjinë sepse nuk kanë kohë të mjaftueshme. Një numër i konsiderueshëm mësuesësh identifikuan kufizimet kohore si një nga vështirësitë në caktimin e kohës së mjaftueshme kompjuterike për klasat si një problem në përdorimin e TIK-ut në mësim.

Është e domosdoshme të theksohet se ndikimi dhe integrimi i TIK-ut në mësim bëjnë të mundur që lëndët të zhvillohen sipas standarteve Europiane.

TIK ofron një mësimdhënie më të thjeshtë, të shpejtë dhe efikase. Mundëson shtrirjen dhe eksplorimin në një gamë më të gjerë informacioni dhe materialesh. Ofron barazi mbi zgjedhjet dhe akseset e informacioneve, duke mundësuar psh edhe nxënësit e zonave rurale të kenë informacione mjaft të vlefshme në mësimdhënie.

Mësuesit duhet të trajnohet për përdorimin sa më efektiv të Tik-ut, në shkollë

Mësimi mund të trajtohet në mënyrën tradicionale por që për vite me rrallë nuk ka rezultuar 100% efikase, kështu që është e nevojshme, që të shfrytëzohen dhe meren në konsideratë metodat dhe platformat bashkohore të TIK-ut, ku roli i këtij të fundit po rezulton të jetë definitiv. TIK-u e bën më tërheqëse dhe më të kuptueshme trajtimin e problemeve fizike dhe të gjithë njohurive, që nxënësi duhet të fitojë gjatë procesit mësimor.

Duke bërë një krahasim të shpejtë mbi tipet e orëve mësimore, mund të themi, që metoda demonstruese rezulton të jetë më efikase nëse përdorim TIK-un. Nëpërmjet përdorimit të TIK-ut nxënësit arrijnë të kenë një perceptim më të mirë të koncepteve dhe trajtimit të problemit. Duke përmirësuar motivimin, sjelljen dhe interesin ndaj mësimi.

Deklaratë e Lektorit

Duke ju referuar kërkesës së kandidatit *Ekrem Salihu* për lekturimin e Tezës së Magjistraturës “Përdorimi efektiv i Tik-ut në shkollat fillore në Kosovë– rast studimor: shkolla fillore “VËLLEZËRIT FRASHËRI” në qytetin e Lipjanit”, unë *Hysri Rrahmani*, me profesion *Profesor i Gjuhes Shqipe*, deklaroj se kam bërë lekturimin e kesaj teme. Tezës së Magjistraturës “Përdorimi efektiv i tik-ut në shkollat fillore në Kosovë– rast studimor: shkolla fillore “VËLLEZËRIT FRASHËRI” në qytetin e Lipjanit”, pas lekturimit të tërsishëm që e kam bërë, i plotson standardet lekturuese dhe është e kompletuar.

Lipjan
Shkurt 2018

Me respekt,

Prof. Hysri Rrahmani

REFERENCA

1. Walter Mathews, *Monster or Messiah?* (Michigan: University Press of Mississippi, 1980)
2. "All About" Computerization. Robert Kling , 1994, 10th & Jordan, Library 012 , Indiana University
3. John a. Lott; "What is Teaching" 2008
4. Education Management Information Systems (EMIS)" f3, Tegegn Nuresu, Wako NESIS/UNESCO November 2003.
5. "Pedagoški Leksikon" (1996). Beograd: Zavod za Udžbenike i Nastavna Sredstva
6. Brooks, Jacqueline G.,and Brooks, Martin G. 1993. *In Search of Understanding: The Case for Constructivist Classrooms*. Alexandria, VA: Association for Supervision and Curriculum Development
7. *EDUCATION AND URBAN SOCIETY*, Vol. 24 No. 4, August 1992 466-476 1992 Children's Television Workshop (New York, New York).
8. Draper, Frank and Mark Swanson. "Learner-Directed Systems Education: A Successful Example," *System Dynamics Review*, Vol. 6, No. 2. Summer 1990 f17
9. http://www.universities.com/Distance_Learning/, shkarkuar në shkurt 2017
10. www.mod.gov.al/botime/html/revista/ shkarkuar në mars 2017.
11. August Vitak "Osnovni problemi vo rabotata na grupi, Beograd, 1964, f57

12. What Do Students Gain From Computer Simulation Exercises? An Evaluation of Activities Desgined to Develop an Understanding of the Sampling Distribution of a Proportion, Kay Lipson, 2000.
13. GAIL BURRILL “Role of Technology in Teaching and Learning Statistics”, , 1997
14. S. Shapley, C. Maloney, and F. CaranikasWalker, “Evaluating the implementation fidelity of technology immersion and its relationship with student achievement,” Journal of Technology, Learning, and Assessment, vol. 9, 2010.
15. John Watson and Butch Gemin , Evergreen Consulting Associates , 2008 , “PROMISING PRACTICES IN ONLINE LEARNING”.
16. Young, Rose, Using Technology Tools in the Public School Classroom, December, 2008,
17. L. Wozney, V. Venkatesh, P. C. Abrami, “Implementing computer technologies: Teachers' perceptions and practices,” Journal of Technology and Teacher Education, vol. 14, no. 1, pp. 173-207, 2006.
18. Rebecca Cartwright, Ken Weiner, and Samantha Streamer-Veneruso Revised May, 2010 ,Student Learning Outcomes (SLO)
19. Amrein, A. L., & Berliner, D. C. (2002). High-stakes testing, uncertainty, and student learning. Educational Policy Analysis Archives, 10(18). Available at www.epaa.asu.edu/epaa/v10n18
20. D. Bullock, “Moving from theory to practice: An examination of the factors that pre-service teachers encounter as they attempt to gain experience teaching with technology during field placement experiences,” Journal of Technology and Teacher Education, vol. 12.

21. Bowman, "Infusing technology-based instructional frameworks in the methods courses: A response to Pope and Golub," *Contemporary Issues in Technology and Teacher Education*, vol. 1, no. 1, 2000.
22. K. Dawson, C. Cavanaugh, and A. Ritzhaupt, "Florida's EETT Leveraging Laptops Initiative and its impact on teaching practices," *University of North Carolina at Wilmington*, vol. 41, no. 2, pp. 143-159, 2008.
23. Danikhel, G.: *Developing Instructional Material for Improving Reading Skills amongst School Students*. Ph.D. (Edu.), Devi Ahilya University, 1998
24. Davis, F. D., Bagozzi, R. P., and Warshaw, P. R. (1989). User acceptance of computer technology: A comparison of two theoretical models. *Management Science*, 35(8), 982-1003.
25. Thurlow, M., Lazarus, S. S., Albus, D., & Hodgson, J. (2010). *Computer-based testing: Practices and considerations (Synthesis Report 78)*. Minneapolis, MN: University of Minnesota, National Center on Educational Outcomes.
26. Ertmer, P. (2005). Teacher pedagogical beliefs: The final frontier in our quest for technology integration. *Educational Technology, Research and Development*,
27. Athanasios Drigas Leyteris ,KoukianakisYannis Papagerasimou , Conference Paper ,Part of the *Lecture Notes in Computer Science Book Series (LNCS, volume 5288)* 2008
28. Trow M. (1970). "Reflections on the Transition from Mass to Universal Higher Education". In *Daedalus* vol 99. Winter 1970: The Embattled University
29. Wang, X. (2012). "An exploration of Biggs' Constructive Alignment in Course Design
30. and its Impact on Students' Learning Approaches". *Assessment and Evaluation in*
31. *Higher Education*,

32. Wang, X. (2012). “An exploration of Biggs’ Constructive Alignment in Course Design
33. and its Impact on Students’ Learning Approaches”. Assessment and Evaluation in
34. Higher Education
35. Kozma, R.(2005), 'National Policies That Connect ICT-Based Education Reform To
Economic And Social Development', Human Technology Vol.1, No. (2)
36. Economic And Social Development', Human Technology Vol.1, No. 2
37. Brown, J. D. Computers in language testing: Present research and some future. 1997
38. Sivakova, D. Ndikimi i teknologjisë së informacionit dhe komunikimit në përmirësimin e
mësimit, Bitola, 2007.
39. UNESCO. Broshura 4: “Të krijojmë mjedise gjithëpërfshirëse e mësimdashëse. Të
pranojmë diversitetin”: Manual për krijimin e mjediseve gjithëpërfshirëse e
mësimdashëse. Bangkok, 2004.
40. Sansanëal, D.N.: Information Technology and Higher Education. UNIVERSITY NEËS,
Vol. 38, No. 46, 2006.
41. Scardamalia, M. & Bereiter, C. (1994). Computer support for knowledge-building
communities. The Journal of the Learning Sciences.
42. Coley, R. J., Cradler, J. & Engel, P. K. (1997). Computers and Classrooms
43. Learning with Technology. 1998 ASCD Yearbook. Alexandria, VA: Association for
Supervision and Curriculum Development.